



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 810 prot.

Tiranë, më 29.4.2020

Lënda: Dërgohet Raportimi i Veprimtarisë Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2019.

Znj. Belinda Balluku

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Tiranë

E nderuar Zonja Ministre,

Duke ju falënderuar për mbështetjen Tuaj të vazhdueshme për Autoritetin e Aviacionit Civil, më lejoni t'ju informoj se në zbatim të Nenit 20, të Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil" i ndryshuar, Raportimi nga Autoriteti pika 1 e tij, Autoriteti i Aviacionit Civil ka hartuar një raport mbi:

- Veprimtarinë vjetore të tij, përfshirë vendimet e marra nga Këshilli Drejtues;
- Pasqyrën financiare vjetore;
- Realizimin e planit të të ardhurave e të shpenzimeve;
- Të dhënat mbi licencat e lëshuara, regjistrat, miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative, të nxjerra në përputhje me këtë ligj.

Ju lutem gjeni bashkëlidhur raportet.

Me respekt,

DREJTOR EKZEKUTIV

Edlira Kraja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL



RAPORTI I VEPRIMTARISË VJETORE
2019

Shkurtime: (Sipas Aplikimeve)

AAC	- Autoriteti Aviacionit Civil
DMA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aeroporteve
DBNJMP	- Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe Mardhënieve me Publikun
DSHP	- Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme
SKRC	- Sektori i Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë
DMSHLA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror
DMSA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Aviacion
DMSOVA	- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Operim dhe Vlefshmërisë Ajrore
EASA	- Agjencia Evropiane e Sigurisë në Aviacion
EC	- Komisioni Evropian
ECCAIRS	- Qendra e Koordinimit Evropian Sistemit Raportimit të Incidenteve në Aviacion
IANS	- Instituti i Shërbimeve të Navigimit Ajror
ICAO	- Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
LSSIP	- Implementimi Rajonal i Qiellit të Përbashkët
RAT	- Risk Assessment Tools
SAAQ	- Pyetëtori Shtetëror i Aktivitetit të Aviacionit
SAFA	- Vlerësimi i Sigurisë për Avionët e Huaj
SSP	- Programi Shtetëror i Sigurisë
ECAA/ ZPEA-	Marrëveshje shumëpalëshe ndërmjet vendeve evropiane rreth një tregu të vetëm.

Tabela e Përmbajtjes

1.	PËRMBLEDHJE	4
1.1	MISIONI	4
1.2	VIZIONI	4
1.3	STRATEGJIA	5
1.4	ORGANIGRAMA	6
1.5	FUNKSIONET	8
1.6	KËSHILLI DREJTUES	9
1.7	DREJTORI EKZEKUTIV	11
2.	OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2019	13
3.	ARRITJET PËR PERIUDHËN	16
4.	PROBLEMATIKAT PËR PERIUDHËN	17
5.	PROGRESI I PUNËS PËR PERIUDHEN SIPAS FUSHAVE PËRKATËSE	18
6.	STATISTIKAT	53

PËRMBLEDHJE

1.1 MISIONI

Misioni i Autoritetit të Aviacionit Civil është të krijojme një mjedis në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, ndërveprimit me operatorët dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit të AAC.

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar ka përgjegjësi të qartë për rregullimin dhe mbikqyrjen e parrezikshmërisë dhe sigurisë në të gjithë veprimtarinë e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit Nr. 10.040 datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Duke qenë anëtare në Organizatat Ndërkombëtare të Aviacionit, në përputhje me detyrimet përkatëse, ne jemi plotësisht të përkushtuar "për të garantuar rritje të sigurt dhe të rregullt të aviacionit ndërkombëtar civil në nivel global". Objektivat tona për nxitjen e sigurisë integrohen me sistemet e ICAOs/ ECAC, / EASAs dhe EUROCONTROL, të traspozuar në legjislacionin bazë të aviacionit civil në R.SH, Kodit Ajror, Ligjit zhvillimin ekonomik në të gjithë vendin, nëpërmjet mbështetjes dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me të gjithë palët e përfshira.

1.2 VIZIONI

Vizioni i Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar është që të ketë në mënyrë të vazhdueshme dhe të përhershme siguri dhe efikasitet në bazën e aktivitetit të tij, duke u bërë kështu plotësisht i përputhshëm me rrjetin evropian të transportit ajror.

Një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit tonë është garantimi i burimeve të mjaftueshme financiare në mënyrë që personeli të ketë aftësitë e duhura dhe trajnimet për përmbushjen e përgjegjësisë së tyre, si në lidhje me sigurinë apo funksione të tjera. AAC-ja përpaket të nxisë konceptet dhe parimet e menaxhimit të parrezikshmërisë dhe sigurisë, si edhe të edukojë ofruesit e operatorët e shërbimit të aviacionit me këto koncepte.

për Autoritetin e AAC si dhe VKM-ve, Urdhrave, Udhëzimeve të dalë me qëllim, garantimin e një transporti ajror të sigurtë.

AAC është e orjentuar drejt përmbushjes me efektivitet dhe efikasitet të nevojave të pasagjerëve dhe shoqërisë në tërësi. AAC kërkon të promovojë zhvillimin e aviacionit civil dhe të thjeshtëzojë


1.3 STRATEGJIA

Strategjia mbi të cilën do të mbështetet përmbushja e qëllimit të autoritetit dhe përpjekjet për të arritur vizionin tonë bazohet në:

- ✚ Marrjen e masave të vazhdueshme nga Menaxhimi i Lartë për të garantuar parrezikshmërinë dhe sigurinë në fushën e aviacionit civil.
- ✚ Sigurimi i mbikqyrjes së vazhdueshme të operatorëve nëpërmjet auditimeve dhe inspektimeve të njoftuara e të panjoftuara.
- ✚ Transpozimi dhe Implementimi i Standarteve Europiane dhe Ndërkombëtare, në legjislacionin kombëtar.
- ✚ Punësimin e personelit me kualifikime të larta, në pajtim me kërkesat e ICAO-s dhe BE-së/EASA
- ✚ Trajnimin sistematik të personelit të ri dhe ekzistues për të garantuar ekspertizën e mjaftueshme për çdo funksion të AAC-së;
- ✚ Vendosjen e një Sistemi Menaxhimi, themeli i të cilit do të jetë baza operative e Autoritetit. Produkti i këtij sistemi do të jetë kontributi në arritjen e përmbushjes së objektivave në autoritet;
- ✚ Bashkëpunimi me Autoritetet e tjera me qëllim harmonizimin dhe standardizimin e procedurave.
- ✚ Aderimi dhe përfaqësimi dinjitoz në organizatat Europiane dhe Ndërkombëtare.
- ✚ Rritja e të ardhurave të AAC-së, si dhe menaxhimi eficient i tyre, duke realizuar investimet në funksion të përmirimit të veprimtarisë së punës.

1.4 Struktura dhe Organika e Autoritetit të Aviacionit Cvil, është miratuar me Urdhër Ministri Nr.2, datë 11/01/2019.

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL



1.5 FUNKSIONET

Aktivitetet e Autoritetit lidhen kryesisht me veprimet rregullatore dhe procedurale për të siguruar parrezikshmërinë ajrore (safety) dhe arritur nivele të pranueshme të sigurisë për të gjithë aktoret e palët e përfshira të Aviacionit Civil të R.SH.

Aktivitetet kryesore të autoritetit përfshijnë por nuk kufizohen në:

- ✚ Liçencimin dhe çertifikimin e transportuesve ajror;
- ✚ Liçencimin dhe çertifikimin e avionëve, përfshirë inspektimet e nevojshme të kushteve teknike dhe operacionale të avionit;
- ✚ Administrimin e regjistrit të avionëve civilë dhe të çdo regjistri tjetër të aviacionit civil;
- ✚ Liçencimin dhe klasifikimin e pilotëve, të anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit dhe personelit tjetër të aviacionit, që duhet licencuar në zbatim të Kodit Ajror, përfshirë liçencimin e instruktorëve të fluturimit për këtë personel;
- ✚ Liçencimin e personelit të shërbimit të lundrimit ajror (SHLA);
- ✚ Liçencimin e inspektorëve të aviacionit;
- ✚ Liçencimin e kontrolluesve të shëndetësisë;
- ✚ Çertifikimin dhe liçencimin e aerodromeve;
- ✚ Mbledhjen e informacionit për personelin e aviacionit dhe avionët, si dhe për shpërndarjen e tyre;
- ✚ Mbledhjen dhe analizimin e raporteve dhe të dokumenteve të tjera për teknologjinë e aviacionit, operimin e avionëve dhe personelin e aviacionit, deri në atë masë që kjo ndihmon, për zbatimin e funksioneve, në përputhje me Kodin Ajror
- ✚ Auditimin e kushteve teknike dhe operuese, si dhe të fuqisë ekonomike të sipërmarrjeve të aviacionit dhe sistemeve trajnuese të aviacionit;
- ✚ Bashkërendimin, çertifikimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë së transportit ajror
- ✚ Përzgjedhjen, çertifikimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror;

- ✎ Organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore në bashkëpunim me autoritetet ushtarake;
- ✎ Funksione të tjera të parashikuara në këtë Kod dhe në aktet e tjera, të dala në zbatim të tij.

1.6 KËSHILLI DREJTUES

Veprimtaria e AAC-së, në zbatim të ligjit për Autoritetin e Aviacionit Civil, ndihmohet nga Këshilli Drejtues, i cili është organi vendimarrës për çështjet administrative dhe financiare të Autoritetit. KD i AAC-së përbëhet nga pesë anëtarë.

Këshilli Drejtues në zbatim të Ligjit Nr. 10233, datë 11/02/2010, i ndryshuar ka këto kompetenca:

- ✎ Miraton programet e zhvillimit të Autoritetit, në përputhje me strategjinë e aviacionit civil;
- ✎ Propozon te Ministri strukturën organizative të Autoritetit dhe strukturën e pagave që do zbatohen;
- ✎ Miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e drejtorive, sektorëve, nëpunësve dhe punonjësve të tjerë;
- ✎ Miraton programin financiar të Autoritetit dhe ndryshimet e tij, për të cilën informon ministrin, si dhe mbikëqyr realizimin e tij;
- ✎ Propozon te ministri masën e tarifave që do të zbatohen nga Autoriteti, sipas pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, për shërbimet që kryen, të cilat miratohen me udhëzim të përbashkët te ministrit që mbulon çështjet e transportit dhe Ministrin të Financave;
- ✎ Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Për vitin 2019 Këshilli Drejtues i AAC-së ka marrë vendime për çështje të transferimit të kapitalit apo të lidhura me buxhetin, strukturën e AAC-së, konkretisht si më poshtë:

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Datë	Nr. Prot	Nr. Vendimi	Datë e vendimit	Emri I vendimit
28/01/2019	6	1	28/01/2019	Vendim mbi ndryshimet në "Përshkrimet e detyrave dhe kërkesave për punësim në AAC"
26/03/2019	11	2	26/03/2019	Vendim për miratimin e trajnimeve
22/05/2019	26	4	22/05/2019	Vendim mbi "Mbi transferim kapitali të pjesëve navigacionale të aeroportit Kukës në pronësi të AAC, Albcontrol Sha"
13/06/2019	28	5	13/06/2019	Vendim mbi miratimin e rregullores së brendshme të AAC
13/06/2019	29	6	13/06/2019	Vendim mbi miratimin e kriterëve të punësimit të AAC
13/06/2019	30	7	13/06/2019	Vendim mbi ndryshimet në programin ekonomik të AAC për vitin 2019
28/06/2019	34	8	28/06/2019	Vendim mbi ndryshimet në strukturën organizative të AAC
28/06/2019	35	9	28/06/2019	Vendim mbi ndryshimin e strukturës organizative të AAC (shtimi i 2 sanitareve dhe 1 shoferi)
28/06/2019	36	10	28/06/2019	Vendim mbi miratimin e punësimit deri në 7 student me kontrata me afat të caktuar
28/06/2019	37	11	28/06/2019	Vendim mbi zgjidhjen e kontratës së qirasë nr. 2019/2 datë 19.11.2019 ndërmjet TBP dhe AAC
18/12/2019	50	12	18/12/2019	Vendim mbi disa ndryshime të Kriterëve të Punësimit në AAC
18/12/2019	51	13	18/12/2019	Vendim për transferim kapitali të aktiveve në pronësi të AAC, Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 3 të Punëtoreve të Qytetit, Bashkia Tiranë
18/12/2019	52	14	18/12/2019	Vendim për derdhjen në Buxhetin e shtetit të fitimit të pashpërndare për vitin 2017 dhe 2018
18/12/2019	53	15	18/12/2019	Vendim për miratimin e programit ekonomik të AAC për vitin 2020

1.7 DREJTORI EKZEKUTIV

Gjatë vitit 2019 Drejtori Ekzekutiv ka marrë masa për drejtimin e Autoritetit në përmbushje të kërkesave të Ligjit Nr. 10233 datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” i ndryshuar, funksioneve të përcaktuara në Kodin Ajror të R.Sh. si dhe përmbushjen e objektivave strategjike të AAC-së. Veprimet përmbledhen, por nuk kufizohen, si më poshtë:

- ✚ Ka dhënë urdhra për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së Autoritetit, në zbatim të disiplinës së punës dhe respektimit të etikës në punë;
- ✚ Ka paraqitur pranë Këshillit Drejtues propozime për ndryshime në strukturë, rialokim fondesh, ndryshim në programin ekonomik etj me qëllim mirëfunksionimin e institucionit.
- ✚ Ka ndërmarrë masa në lidhje me projektimin dhe përmirsimin e ndryshimeve në Kodin Ajror;
- ✚ Është siguruar që objektivat e vendosura në Planet Vjetore nga drejtoritë e AAC janë përmbushur, duke monitoruar në mënyrë periodike nëpërmjet programit Microsoft Project, zbatimin e planit të punës;
- ✚ Për herë të parë në kuadër të ngritjes së sistemit të menaxhimit të cilësisë, AAC ka zhvilluar mbledhje të rishikimit të drejtimit në nivel menaxherial duke përfshirë të gjitha pikat e detyrueshme për diskutim në vijim të ISO 9001:2015. Hap i rëndësishëm vendosja e objektivave për çdo drejtori me afat dhe persona përgjegjës, krijimi i regjistrit të riskut të AAC dhe vlerësimi i masave zbutëse, krijimi i databazës së konsoliduar për menaxhimin e gjetjeve të brëndshme dhe të jashtme në AAC, rishikimi i vlerësimit të përdoruesve të shërbimeve të AAC, vlerësimi i furnitorëve etj.
- ✚ Ka ngritur një grup pune dhe hartimi i planit të veprimit për hartimin e tabelave të përputhshmërisë lidhur me rregulloret e transpozuar dhe atyre në proces në vijim të marrveshjes së ECAA.
- ✚ Ka kryer monitorim të vazhdueshëm dhe angazhim direkt lidhur me ecurinë e projektit Airfield 2020 pranë TIA-s. Monitorim i përmbushjes së detyrimeve sipas afateve lidhur me fazën 1 të këtij projekti dhe vlerësime e rekomandime lidhur me riasfaltimin e pistës duke siguruar aplikimin e masave më të lartë të sigurisë në operim dhe impaktin më të ulët tek pasagjerët. Koordinimi me të gjitha palët e përfshira në këtë proces si dhe diskutime apo marrjen e mendimeve të ekspertëve të organizatave ndërkombëtare.

- ✚ Ka kërkuar marrjen e masave konkrete me afate dhe persona kompetentë, nga TIA në kuadër të gjetjeve të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë, në cilësinë e Kryetarit të KSHKA.
- ✚ Është angazhur dhe ka krijuar të gjitha mundësitë për mbrojtjen e të drejtave të pasagjereve, nëpërmjet zyrës së të drejtave të pasagjerëve të alokuar pranë aeroportit, ndërgjegjësit të këtyre të drejtave nëpërmjet prezencës në aeroport, komunikimit audioviziv, faqes zyrtare të AAC-së apo adresimin e kësaj problematike pranë takimit me përfaqësues të kompanive ajrore.
- ✚ Ka monitoruar publikimin e buletinit mujor për punën e AAC-së, e cila shërben për të rritur transparencën e institucionit me publikun e gjerë dhe median kombëtare;
- ✚ Ka miratuar Planin e vazhdueshëm të Trajnimeve të detajuar për çdo pozicion, duke u mbështetur në vlerësimet e organizatës europiane trajnuese mbi rritjen e kapaciteteve dhe kualifikimeve të inspektorëve, e cila synon të përafrojë kërkesat e nevojshme të stafit, si detyrim i Organizatave Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.
- ✚ Në vijim të kontakteve të vazhdueshme me EASA, ka krijuar mundësinë dhe koordinuar vizitën e Drejtorit të Përgjithshëm të EASA Z. Patrick Ky, në datën 5-6 Shkurt 2019. Ky takim ishte një mundësi e mirë për promovimin e sigurisë në aviacion dhe sfidat e tij, për shtetin shqiptar dhe Autoritetin e Aviacionit Civil.
- ✚ Ka marrë pjesë në Global Aviation Summit Arabia Saudite në datat 1-2 Prill.
- ✚ Ka pritur në Tiranë Drejtorin e Përgjithshëm të AAC-së Kosovë në 4 Prill 2019 në një takim në lidhje me forcimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet dy Autoriteteve tona por dhe më gjerë në rajon. Propozimin për një Marrëveshje Mirëkuptimi e cila do të thellonte më tej marrëdhëniet mes dy institucioneve përmes asistencës së ndërsjelltë të inspektorëve, shkëmbimin e praktikave të mira etj
- ✚ Ka marrë pjesë në Takimin e Drejtorëve të Përgjithshëm të ECAC në 6-7 Maj 2019.
- ✚ Ka marrë pjesë në Mbledhjen e EASA Management Board 4 Qershor 2019.
- ✚ Është angazhuar në grupin negociator për Aeroportin e Vlorës si një projekt mjaft i rëndësishëm jo vetëm për aviacionin por dhe për zhvillimin ekonomik dhe atë të turizmit.
- ✚ Ka ngritur grupin e punës dhe monitoruar në mënyrë të vazhdueshme mbi mbylljet e gjetjeve të USOAP.
- ✚ Ka marrë pjesë në Mbledhjen e Provisional Council, në Eurocontrol me datë 13 Qershor 2019.

- ✚ Ka zhvilluar takimin në Ohër me Drejtorin e Përgjithshëm të AAC Maqedonisë së Veriut, 4 Korrik 2019 ku u diskutua për disa çështje të rëndësishme si menaxhimi i hapësirës ajrore mbi Liqenin e Ohrit, e cila përdoret nga pala maqedonase për avionët që flyturojnë në Aeroportin e Ohrit, për të vijuar me koordinimin e punëve për shkëmbime ekspertize për zhvillimin e aktiviteteve mbikqyrëse të entiteteve ajrore të dy vendeve, mundësinë e zhvillimit të trajnimeve të përbashkëta.
- ✚ Ka marrë pjesë në takim për Balkan Aviation Normalisation Meeting (NATO) 11 Korrik 2019.
- ✚ Ka marrë pjesë në DGCA Special Meeting Spanjë, 29-31 Gusht 2019
- ✚ Ka përfaqësuar Shqipërinë në Asamblenë e ICAO-së në Montreal Kanada 24-28 Shtator 2019.
- ✚ Ka ndërmarra masa për monitorimin e gjetjeve të brëndshme dhe të jashtme të institucionit.
- ✚ Janë ngritur grupe pune për mbikqyrjen dhe inspektimin e operatoreve;
- ✚ Ka krijuar Grupin e safety për analizimin e ngjarjeve të detyrueshme për tu raportuar në Aviacionin Civil.
- ✚ Ka lëshuar autorizime, miratime të liçencave sipas kategorive përkatëse si dhe certifikatave në funksion të përmbushjes së detyrimeve në Kodin Ajror.
- ✚ Ka ngritur një grup pune mbi monitorimin e zbatimin të standarteve dhe përmbushjen e performancës pranë TIA-s.
- ✚ Ka nxjerrë urdhra të brëndshëm për prokurimin e objekteve të parashikuara në regjistrin e parashikimeve për vitin 2019;
- ✚ Ka marrë vendime mbi miratimin e procedurave, manualeve të brëndshme të autoritetit me qëllim permirësimin e punës në AAC.

2. OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2019

Objektivat të AAC për vitin 2018, në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Ajror dhe rregulloret kombetare, kryesisht konsistojnë si më poshtë:

- ✚ Detyra liçencuese/certifikuese dhe aprovime/miratime të operatoreve të Aviacionit Civil
Certifikimi/ Liçencimi i operatorëve

Çertifikimi/Liçencimi i stafit të operatorëve

- ✚ Detyra mbikëqyrëse të Operatoreve të Aviacionit Civil, realizimi i plotë i planit të mbikqyrjes.
 - Faza përgatitore për kryerjen e inspektimeve/auditimeve
 - Ndjekja e planeve të inspektimit pranë operatorëve
 - Ndjekja e gjetjeve të rezultuara nga inspektime/auditime të operatorëve

- ✚ Detyra rregullatore në funksion të standartizimit të rregullore në fushën e transportit ajror të cilat rrjedhin në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe marrëveshjes “Për krijimin e një zone të përbashkët në fushën e aviacionit civil”. Transpozim i rregulloreve europiane të përfshira në Aneksin 1 të Marrëveshjes Shumëpalëshe. Hartimi, monitorimi dhe përshtatja e rregulloreve, procedurave të brëndshme dhe të jashtme në përputhje me standardet e ICAO-s dhe rregulloreve të BE.

- **Miratimi i dokumenteve me rëndësi strategjike**

Ka miratuar të gjithë dokumentat të cilat kanë të bëjnë me strategjitë për zhvillimin e aviacionit në Republikën e Shqipërisë dhe në rritjen e sigurisë në Operimet Ajrore (Flight Safety)

- **Hartimi i një plani për të garantuar përputhshmërinë e plotë të legjislacionit, akteve rregullatore dhe procedurave me ato të Bashkimit European.**

Hapja e pritshme e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, do të paraqesë një sfidë të rëndësishme në drejtim të përafrimit të të gjithë korpusit ligjor dhe rregullator të vendit me standardet europiane.

Në përballje të kësaj sfide, AAC ka hartuar një plan të plotë masash në interes të rishikimit, plotësimit dhe përafrimit të të gjithë bazës ligjore, rregullatore dhe procedurale me atë të BE.

- **Hartimi i bazës së nevojshme ligjore lidhur me mjetet ajrore e pilotuara në distancë, rregullimi i heliporteve etj.**

Zhvillimet e vrullshme në fushën e aviacionit civil dhe posaçërisht futja e gjerë në përdorim e mjeteve të papilotuara ajrore apo kërkesat e industrisë për ndërtimin e heliporteve shtojnë nevojën që edhe vendi ynë të krijojë bazën e nevojshme ligjore për të shfrytëzuar mundësitë, por edhe për të përballuar sfidat.

- **Ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë**

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së AAC, do të synojë të krijojë kushtet që institucioni të kryejë më mirë funksionet në kushtet e një faze të re të zhvillimit të sektorit të aviacionit civil në vend.

Qëllimi i themelimit dhe zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve tona nëpërmjet monitorimit, matjes dhe raportimit në lidhje me performancën dhe menaxhimin e sistemeve të garantimit të sigurisë dhe proceseve të tyre. Mbikqyrja dhe monitorimi i vazhdueshëm i parrezikshmërisë dhe sigurisë si dhe efienca maksimale është thelbi i aktiviteteve të Autoritetit.

Pjesë e SMC është edhe miratimi i Procedurave Standarde Operacionale (PSO) të AAC. Procesi i hartimit të dokumentacionit bazë në vijim të konsulencës ISO ka përfunduar. AAC është në një fazë të rëndësishme të implementimit dhe zbatimit të procedurave, duke synuar që këtë vit të certifikohemi me ISO 9001:2015.

- Hartimi i një plani të integruar studimesh në fushën e AAC

Zhvillimit të aviacionit civil në vend duhet t'i paraprijë një program i gjerë studimesh, të cilat do të synojnë të identifikojnë potencialet e pashfrytëzuara, të përcaktojnë objektiva të rinj si dhe të rekomandojnë mënyra dhe rrugë të përshtatshme për të mundësuar shndërrimin e hapësirës ajrore të vendit në një përmasë të re zhvillimi për ekonominë, turizmi, kulturën, ruajtjen e mjedisit dhe garantimin e sigurisë kombëtare.

Studimet e vlefshme në këtë fushë do të mundësohen falë përpjekjeve të bashkërenduara të AAC me institucionet e tjera të vendit dhe të huaja, ku roli i universiteteve dhe i sipërmarrjeve private është me rëndësi të veçantë.

- Hartimi i raporteve kryesore për veprimtarinë e AAC, i paraqitet në zbatim të ligjit brënda afateve kohore Këshillit Drejtues dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjithashtu përvec sa më lart cdo drejtori brënda AAC-së harton Plane Vjetore me objektiva të matshme dhe persona përgjegjës.

AAC angazhohet gjithashtu në:

- ✚ Koordinimin dhe përfaqësimin në Organizatat Ndërkombëtare të ICAO, EASA, EUROCONTROL, ECAC, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e RSH me këto organizata;
- ✚ Zbatimi i Planeve Korrigjuese të rezultuara nga detyrat e lëna nga vizitat e organizmave të jashtëm auditues.
- ✚ Koordinimi me strukturat si Policia e Shtetit, Dogana Shqiptare, Forcat Ajrore, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme me qëllim rritjen e masave dhe garantimin e sigurisë në aviacion.
- ✚ Koordinim, bashkëpunimin dhe zhvillimin e takimeve dypalëshe me Autoritetet e vëndeve fqinje.
- ✚ Menaxhimi i burimeve njerëzore të AAC në funksion të kryerjes së detyrave përkatëse me qëllim përmbushjen e standardeve për ruajtjen dhe rritjen e cilësisë në Aviacionin Civil;
- ✚ Raportime të brëndshme dhe planifikime;
- ✚ Zbatimin e strategjisë dhe politikave ekonomike-financiare të Autoritetit, të përcaktuara nga strukturat drejtuese, Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv;

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

- ✚ Pajisjen me kredenciale për inspektoret e AAC-së;
- ✚ Evidentimi i vonesave dhe anulimeve të fluturimeve të shoqërive ajrore që operojnë në Republikën e Shqipërisë, hartimi i raporteve mujore dhe monitorimi i zbatimit të të drejtave të pasagjerëve për çdo rast.
- ✚ Mbështetjen e drejtorive operacionale dhe teknike në përmbushjen e detyrave funksionale;
- ✚ Garantimi i shpërndarjes së fondeve sipas nevojave të drejtorive;
- ✚ Garantimi i kushteve për ushtrimin normal të veprimtarisë së Autoritetit;
- ✚ Përfaqësimi ligjor i AAC-së në të gjitha nivelet e gjykimit;
- ✚ Realizimi i procesit të prokurimit, me qëllim realizimin në kohë dhe në mënyrë eficiente të planit financiar.

Për sa me sipër, përdoruesit e shërbimeve të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar për periudhën janë:

Klientet		NIPT	Shërbimi
1	Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza" (TIA)	K51612012D	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
2	ALBCONTROL sh.a	J61908011H	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
3	Kompania Ajrore ALBAWINGS	L51418010M	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
4	Kompania Ajrore AIR ALBANIA	L82113028I	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
5	MJEKU AEROMJEKSOR		CERTIFIKIM / MJEKU
6	SHEGA AIR	L41803004T	LEJE FLUTURIMI
7	HELIKOPTERS ALBANIA	L11808017D	CERTIFIKIM / MBIKQYRJE
8	FEDERATA AEREONAUTIKE SHQIPTARE	K41919005R	LICENSIM PILOTESH PARAGLAJDER

3. ARRITJET PËR PERIUDHËN

Gjatë vitit 2019 arritjet kryesore kanë konsistuar në:

- ✚ Është bërë kryerja e ristrukturimit të institucionit sipas një propozimi të financuar nga Komisioni European dhe Eurocontrol, i cili në thelbin e tij ka rritjen e efikasitetit të punës së institucionit.
- ✚ Është kryer mbrojtja e të drejtave të pasagjerëve dhe kompensimi rekord i tyre për periudhën 2018-2019 me 2064 çështje të mbyllura dhe 1384 çështje të hapura, të cilat janë pranuar dhe priten të kompensohen, nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe rolit ndihmës të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe në vecanti, stafit të AAC-së së të drejtave të pasagjerëve të alokuar pranë aeroportit;
- ✚ Është kryer publikimi në vazhdimësi i buletinit mujor Posta Ajrore, për punën e AAC-së, e cila shërben për të rritur transparencën e institucionit me publikun e gjerë dhe median kombëtare; publikimi çdo muaj i performancës së operatorëve ajror;
- ✚ Është bërë miratimi i një Plani individual Trajnimesh për stafin e autoritetit të detajuar për çdo pozicion, në bashkëpunim me organizatat europiane trajnuese, mbi përmbushjen e standarteve europiane të kualifikimeve të inspektorëve teknik;
- ✚ Gjatë vitit 2019 janë mundësuar katër trainime të rëndësishme in house, -ICAO EUR/NAT Aerodrome Certification Workshop 15-17 Janar 2019, Kursi Safety Regulation of Aerodromes Basic Course 20-24 Maj 2019 dhe ICAO AVSEC Airport Security Supervisors Course 16 me 25 Korrik 2019, AAC Transportation Security Administration Visit 30 Korrik-1 Gusht 2020), News Basic Regulation
- ✚ Është realizuar Çertifikimi i Kompanisë Ajrore “Air Albania”, e cila u finalizua në 2019 në vijim të një pune voluminoze, serioze dhe të përkushtuar të inspektorëve të AAC-së
- ✚ Janë mbyllur gjetjet e EASA-s mbi OPS audit.
- ✚ Janë mbyllur gjetjet e EASA-s mbi ANS audit.
- ✚ Janë hartuar materiale udhëzuese për operatorin nga çdo drejtori teknike.

4. PROBLEMATIKAT PËR PERIUDHËN

✚ Shumë pozicione pune në AAC, goftë dhe të nivelit "specialist", sipas standarteve të Bashkimit Evropian, ndër të tjera kërkojnë pasjen e eksperiencës në industrinë e aviacionit. Në kushtet kur sistemi aktual e në fuqi, i punësimit apo lëvizjes në karrierë vë barriera burokratike, të pa lidhura me performancën apo eksperiencat, kualifikimet dhe aftësitë në punë, plotësimi i këtij kriteri ka qënë i pamundur deri më sot. Për rrjedhojë, jo vetëm nuk ka qënë i mundur punësimi i specialistëve të fushës, por ka rezultuar i vështirë motivimi dhe mbajtja në punë e specialistëve ekzistues. Ky problem shoqërohet me kosto financiare dhe me kosto në burime njerëzore, duke detyruar institucionin që shpesh herë të lidhë kontrata shërbimi për kontraktimin e ekspertëve të huaj të fushës, për mbulimin e funksioneve të caktuara. Për gjatë vitit 2019 institucioni ka pasur vende vakante të paplotësuara në ndjekje të shpalljes së këtyre pozicioneve dhe zhvillimit të konkursit pranë DAP.

✚ Gjithashtu gjatë kryerjes së funksioneve mbikqyrësë ka pasur vështirësi në realizimin e detyrave, për shkak të pengesave të lidhura me pamundësinë e shpërblimit të punës jashtë orarit, si edhe të lidhura me kapacitetin e pamjaftueshëm rast pas rasti. Psh sektori i Pasagjerëve duhet të gjendet pranë pasagjerit në cdo orar të mundshëm ditë ose natë si dhe përgjatë ditëve të pushimeve zyrtare apo të Shtunave dhe të Dielave.

Po ashtu inspektorët SAFA mund të duhet të punojnë jashtë orarit zyrtar gjithashtu. Pra, sistemi i shërbimit civil, ndonëse një sistem i rekomanduar për administratën publike, nuk ka rezultuar efektiv për administratën e Autoritetit të Aviacionit Civil, ndoshta edhe për specifikën që mbart ky institucion.

✚ Adoptimi i shpeshtë i legjislacionit vendas me atë të EU, si dhe fakti që Shqipëria nuk është EU Member, e vështirëson aplikimin dhe harmonizimin në aspektin kohor të rregullave dhe kërkesave të EU;

✚ Mosmiratimi i rregulloreve të dërguara në MIE gjatë vitit 2019.

✚ Mos miratimi i Kodit Ajror të përmirësuar i cili është edhe gjetje e EASAs

5. PROGRESI I PUNËS PËR PERIUDHËN SIPAS FUSHAVE PËRKATËSE

Më poshtë është paraqitur një tablo e përmbledhur e veprimtarisë kryesore vjetore sipas fushave për vitin 2019.

5.1 Çështje të Parrezikshmërisë (safety) në flututim për operatorët ajror

Në kryerjen e detyrave të saj funksionale dhe institucionale, AAC-ja promovon zhvillimin e Aviacionit Civil duke garantuar sigurinë në fluturim, përputhjen me standardet dhe praktikën e rekomanduara të ICAO-s po ashtu dhe Rregulloret dhe Direktivat e BE-së si dhe kërkesave të tjera të lidhura me çështjet e Operimeve, Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes, si dhe të Ekuipazhit Ajror dhe Organizatave përkatëse.

Ndër aktivitetet kryesore të kësaj drejtorie përgjatë vitit 2019 mund të përmendim:

5.1.1 Përmbledhje të aktivitetit në fushën e vlefshmërisë ajrore.

Gjatë këtij viti dinamika e punës ka konsistuar kryesisht:

- 2 Rishikime rregulloresh (748/2012, 1321/2014)
- 1 Përgatitje e tabelave të përputhshmërisë së rregullores (748/2012)
- 2 Miratime të "Programit të mirëmbajtjes" (ABN, AWT)
- 4 Miratime të "Manuali i Menaxhimit të Vazhdueshmërisë së Vlefshmërisë Ajrore CAME" (ABN,AWT,HA)
- 1 Miratim i revizionimit të "Management Organisation Exposition (MOE)" (HA)
- 2 Miratime/pranime të "Organizatës së Menaxhimit të Vazhdueshmërisë së Vlefshmërisë Ajrore CAMO" (ABN,AWT)
- 4 Miratime/pranime të "Lista Minimale e Pajisjeve për Fluturim (MEL)" (ABN,AWT)
- 1 Miratim të "Çertifikata e Vlefshmërisë Ajrore CofA" (ABN)
- 2 Miratim të "Çertifikata e Rishikimit të Vlefshmërisë Ajrore ARC" (ABN,AWT)
- 1 Miratim të "Çertifikata e Zhurmave NC" (ABN)
- 1 Revizionimi të "Manualit të brendshëm të sektorit të vlefshmërisë ajrore."
- 1 Miratim i menaxherit të linjes së operatorit Helicopters Albania sh.p.k
- 5 Miratime/ rinovime të "Liçencat e personelit të mirëmbajtjes së avionëve sipas pjesës 66" (AWT)
- 1 Pranim të "Organizatës së Mirëmbajtjes "AlbaTechnics" Part-145"
- 14 Audit/Inspektime pranë operatorëve: AWT – Albawings sh.p.k, ABN – Airalbania sh.p.k, HA – Helicopters Albania sh.p.k, AlbaTechnics" srl., Turkish Technics, AeroService.
-

Gjetje të rezultuara gjatë vitit 2019 pranë operatorëve janë 9 dhe 1 observacion, të cilat janë të nivelit me mospërputhshmëri të vogël e janë të mbyllura.

5.1.2 Mbikqyrja e Sigurisë në operim;

- Janë kryer 69 SAFA Inspection (7 SANA)
- Janë kryer gjithsej 10 En Rout inspection (Cocpit dhe Kabinë) , për operatorët ajror "Albawings" dhe "Air Albania".
- Realizimi i Auditit gjatë fazës së vizitës Standartizuese të EASA-s në AAC në lidhje me operimet ajrore (28 Janar-01 Shkurt 2019). Mbyllja e gjetjeve në masën 90 %.
- Janë pregatitur masat korrigjuese për gjetjet e realizuara nga Audit i brendshëm dhe mbyllja e tyre sektorin OPS/SAFA

- Janë miratuar Rishikimet Nr.5, 6 dhe 7 të Manualit të Procedurave të Operimeve Ajrore i sektorit të OPS-it, me vendim Nr. 02 Datë 17.01.2019.
- Është mbyllur procedura për lëshimin e COA, për kompaninë Air Albania në datë 26.03.2019.
- Janë miratuar Manualet Part A,B,C dhe D (OM-A/B/C/D), Lista Minimale e Paisjeve (MEL) sipas revizionimeve përkatëse për kompanitë ajrore “Albawings” dhe “Air Albania”
- Është miratuar në gjuhën shqipe i Manualit të Procedurave të Inspektimit në VQA për Inspektorët, DMSOVA-SAFA-MAN-01, Botimi 3, Rishikimi 00 (24 dhjetor 2019)
- Përfundimi i ndryshimeve në Rregulloren Europiane No.965/2012 për Projekt Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjate vitit 2019 janë kryer 33 inspektime prane operatorëve Albawings dhe Air Albania.

Gjetje të rezultuara gjate vitit 2019 pranë operatorëve Albawings dhe Air Albania janë 19, te cilat janë të nivelit me mospërpuethshmëri të vogël.

Gjetje të rezultuara nga inspektimet enroute, gjatë vitit 2019 pranë operatorëve Albawings dhe Air Albania janë 2 , të cilat janë të nivelit me mospërpuethshmëri e vogël.

5.1.3. Licensimi i personelit ajror;

- Janë zhvilluar 6 inspektime en-route-cabin pranë kompanisë “Albawings” shpk dhe në Shoqërinë “Air Albania” sh.p.k.
- Është kryer 1 Inspektim “Demo Flight” për “Air Albania”
- Janë zhvilluar 4 Audite/Inspektime në shoqërinë “Albawings” shpk dhe në Shoqërinë “Air Albania” sh.p.k.
- Janë zhvilluar 2 Audite/Inspektime pranë ambjenteve të Ekzaminuesve Aeromjekësorë AME.001 dhe AME- 002(Aplikant).
- Është kryer Inspektimi në Organizatën e Huaj të trajnimit për Paraglajde, “Sky Riders”, Prilep, Maqedoni e Veriut, me qëllim procesin e Pranimit të saj.
- Në kuadër të programit SAFA, inspektorët e këtij sektori kanë kryer 46 Inspektime SAFA/SANA.
- Është kryer detyra e përcjellë mbi ndjekjen e planit të veprimeve për ECAA, në lidhje me përgatitjen e Draft Urdhrit të Ministrit Nr. 250/2014, me përfshirje të 10 amendimeve të Reg. (EU) No. 1178/2011, i cili është miratuar me Urdhërin e Ministrit Nr. 262, datë 28.06.2019 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative lidhur me ekuipazhin ajror”
- Janë hartuar dhe përcjellë tabelat e përputhshmërisë për Urdhërin e Ministrit Nr. 28.06.2019 me Reg. (EU) No. 1178/2011, të amenduar.
- Është hartuar Drafti i Rregullores, i cili u miratua me Urdhërin e Ministrit “Mbi kushtet dhe Mënyrat e Përdorimit të Paraglajdëve dhe Deltaplaneve”, datë 03.05.2019.
- Është miratuar Materiali Udhëzues për Certifikimin e mjekëve AME dhe certifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit të kabinës, botuar në faqen zyrtare të AAC-së Nëntor 2019.
- Është miratuar amendimi i Procedurave të Licensimit dhe Mbikqyrjes së Ekuipazhit Ajror, Nëntor 2019.
- Janë miratuar procedurave të rishikuara të licensimit, validimit, kategorizimit të pilotëve të Paraglajdit dhe Deltaplanit, Dhjetor 2019.
- Janë bërë 14 procese Validimi dhe Rivalidimi për Pilotët, të cilët operojnë me shoqërinë “Air Albania” shpk, Mars-Shtator 2019.

- Janë pranuar 7 Anëtarë të lartë, të kabinës (SCCM), për të ushtruar privilegjet e licensës së tyre në shoqërinë “Air Albania” shpk.
- Është lëshuar certifikata e Ekzaminuesit Aero-mjekësor AME Nr.002, Dr. Iirjan Bashllari, për Certifikimin mjekësor të Ekuipazhit Ajror.
- Është bërë pranimi i certifikatës së ekzaminuesit Aero-mjekësor Dr. Vincenza Indelicato.

5.1.4. Cështje të regjistrimit të avionit dhe Standartizimit Teknik, aktiviteti kryesor ka konsistuar si më poshtë:

- Janë përcjellë në MIE për miratim në vitin 2019, grupi i rregulloreve të projektuara në AAC si në vijim:

Projektimi i rregullave të operimit për balonat Reg.(EU) 2018/395 datë 13.3.2018;

Projektimi i rregullave të operimit për planerat Reg. (EU) 2018/1976;

Projektimi i rregullave për gjobat dhe penalitetet e EASA-s;

- Ka mbaruar përgatitja e paketës përcjellëse për miratim në kuadër të standartizimit, të Rregullores Evropiane Nr. 2018/1139 e datës 4 korrik 2018 "Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një Agjencie Evropiane të Sigurisë së Aviacionit" që amendon Rregulloren (KE) Nr.2111/2005, Rregulloren (KE) 1008/2008, Rregulloren (BE) Nr.996/2010, Rregulloren (BE) Nr. 376/2014 dhe Direktivat 2014/30 / BE dhe 2014/53 / BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, si dhe që shfuqizon Rregulloret (KE) Nr. 552/2004 dhe (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 3922/91); Projektimi i NBR-së, koordinimi për konsultim të brendshëm me njësitë e lidhura në AAC, përgatitja e paketës përcjellëse për miratim;
- Është kryer përgatitja e paketës përcjellëse për miratim dhe i tabelave përkatëse të përpuethshmërisë për Projekt-Kodin Ajror me qëllim përmirësimin e tij;
- Janë bërë standartizimet e Rregullores 748/2012 në versionin e saj të konsoliduar përkatësisht të 4 amendimeve të saj (Reg (EU)No. 7/2013, No.69/2014, No.2015/1039 dhe No. 2016/5), hartimi i tabelave të përpuethshmërisë në anglisht dhe në shqip, si dhe hartimi i relacionit, shkresës përcjellëse për Ministrin dhe memos informuese për Drejtorin Ekzekutiv në lidhje me finalizimin e projekt-aktit;
- Është bërë standartizimi i versionit të konsoliduar të Rregullores Nr. 1321/2014 “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra“, përkatësisht me amendimet e saj Reg.2015/1088, Reg.2015/1536 dhe Reg.2018/1142, hartimi i tabelave të përpuethshmërisë në anglisht dhe në shqip, si dhe hartimi i relacionit, shkresës përcjellëse për Ministrin dhe memos informuese për Drejtorin Ekzekutiv në lidhje me finalizimin e projekt-aktit;
- Është bërë standartizimi i versionit të konsoliduar të Rregullores Nr. 965/2012, hartimin e tabelave të përpuethshmërisë në anglisht dhe në shqip, si dhe hartimin e relacionit, shkresës përcjellëse për Ministrin dhe memos informuese për Drejtorin Ekzekutiv në lidhje me finalizimin e projekt-aktit; Në proces miratimi në MIE

- Është bërë standartizimi i ndryshimit të EU reg 1178/2011, hartimi i tabelave të përputhshmërisë në anglisht dhe në shqip, si dhe hartimi i relacionit, shkresës përcjellëse për Ministrin dhe memos informuese për Drejtorin Ekzekutiv në lidhje me finalizimin e projekt-aktit; Miratuar me Urdhër Ministri Nr.262/2019;
- Është bërë transpozimi i plotë i Rregullores së BE-së Nr. 2016/583 që ndryshon Rregulloren e BE-së Nr.1332/2011 që përcakton “Kërkesat e përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave të operimit për shmangien e përplasjeve ajrore”, hartimi i tabelave të përputhshmërisë në anglisht dhe në shqip, si dhe hartimi i relacionit, shkresës përcjellëse për Ministrin dhe memos informuese për Drejtorin Ekzekutiv në lidhje me finalizimin e projekt-aktit; Në proces miratimi në MIE;

✚ Gjatë vitit 2019 janë realizuar gjithashtu projektet si më poshtë:

- Është bërë trajtimi i problematikave në operime gjatë rikonstruksionit të rrugëve lidhëse dhe pistës së Aeroportit “Nënë Tereza” dhe i problematikave të vërejtura në këtë aeroport “Për organizimin e procesit të alokimit të slotëve”.
- Është bërë trajtimi i kërkesës së bërë nga Shoqëria “Shega Air” sh.p.k për heqjen e avionit ZA-KEI, A 109- A1, me numër 7258, nga Regjistri i Avionëve Civil Shqiptar.
- Është bërë trajtimin e çështjes së ngritur nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, për materializimin e risqeve të kontratave koncesionare/PP-Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës.
- Është bërë përgatitja e procedurave të nevojshme për regjistrimin e avionit në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të pajisjes me certifikatë të operatorit ajror. Koordinimi i Procesit të Çertifikimit të Shoqërisë Air Albania, kontrolli dhe standartizimi i dokumentacionit të prodhuar nga AAC në kuadër të këtij procesi deri në finalizimin e tij.
- Është bërë përgatitja e informacioneve në kuadër të MSA dhe raportimit në Nënkomitetin e Transportit, Mjedisit dhe Energjisë.
- Është bërë koordinimi me institucionet përkatëse dhe KE-në për vizitën vlerësuese të Marrëveshjes së ECAA-së.

✚ Pjesëmarrjet në aktivitete dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale për vitin 2019 janë si në vijim :

- Është marë pjesë në takimin sqarues për procesin “Screening” në Bruksel për Kapitullin 14 dhe 28.
- Është marë pjesë në Rishikimin e Projekt- Kodit Ajror, ndërveprimi me MIE, Ministrinë e Mbrojtjes dhe QKB për dakordësim të disa propozimeve për projekt- Kodin Ajror të RSH-se dhe finalizimi i paketës shoqëruese të projektit. Këshilli i Ministrave ka dërguar propozimin në Kuvendin e RSH-së në muajin Nëntor 2019 dhe pritet shqyrtimi përgjatë vitit 2020.
- Është marë pjesë në takimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitullin 14 “Politikat e Transportit” dhe kapitullin 21 “Rrjetet trans-evropiane”.
- Është marë pjesë në Komitetin e Përbashkët të Marrëveshjes Shumëpalëshe, prezantimi i progresit të Shqipërisë në përmbushjen e detyrimeve të Marrëveshjes, dhe follow up me plotësim informacioni.
- Është bërë koordinimi me MIE, planifikim dhe vendosje prioritetesh për rregullbërjen për vitin 2019-2020 dhe për Planin Kombëtar të Integritimit (PKIIE 2020-2022).

AVIONET KOMERCIAL PËR TRANSPORT PUBLIK

Nr.	Data e regjistrimit	Emri i firmës prodhuese	Data e prodhimit	Tipi	Numri Serial	Kompania pronare /Operatori	Shënja e regjistrimit	Data e çregjistrimit nga RACSH	Numri i Çertifikatës	Shënime
1	23/3/2016	BOEING	1990	B 737-500	24972	AEROTRON Irland Ltd/ Albawings	ZA-AWA		573	Terheqesi i çertifikates. G. Tole
2	04.10.2017	AIRBUS	1994	A 320-212	0427	AIRWAYS	ZA-ABB	28.12.2017	28	Çregjistruar me kerkese te pronarit
3	26.01.2018	BOEING	1989	B 737-400	24352	Me qira Albawings	ZA-AWB		574	Terheqesi i çertifikates. G. Tole
4	11.12.2018	BOEING	1990	B 737-500	24972	Albawings	ZA-AWA		573	Ndryshim pronesie Terheqesi i çertifikates. E. Turja
5	11.12.2018	BOEING	1993	B 737-400	27171	AEROTRON Irland Ltd/ Albawings	ZA-ALB		288	Terheqesi i çertifikates. E. Turja
6	19.03.2019	AIRBUS	2007	A 319 312	3142	WILMINGTON TRUST SP/ Airlbania	ZA-BEL		792	Terheqesi i çertifikates. S. Dilek

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

AVIONE PRIVATË DHE KOMERCIAL JO PER TRANSPORT PUBLIK

No.	Data e regjistrimit	Emri i firmes prodhuese	Data e prodhimit	Tipi	Numri serial	Kompania pronare	Shenja e regjistrimit	Data e cregjistrimit nga RACSH	Numri i certificates
1	27.05.2015	Augusta Westian	1982	A109-AII	7258	Shega Air	ZA-KEI		6873
2	21/10/15	Cessna 550	1979	Citation	550-0060	SHega Air	ZA-AMA		313
3	07/12/15	Sociata TB-10	1989	AEROSP	935	Agim Mucaj	ZA-AGM		16
4	22/06/16	ZENAIR	2011	STOL CH-701	7-8503	Endri Cunaaj	ZA-EDE		2787
5	21/01/16	WSK "PZL MIELEK" Poland An-2	1974	An-2	1G156-29	Shega Air	ZA-DEA		2133
6	18/07/16	ZENAIR	2011	STOL CH-701	7-8504	A.E.E Sh.p.k	ZA-EXN		3316

5.2 Çështjet Ligjore të Aviacionit dhe Harmonizimi i Legjislacionit

Gjatë vitit 2019 janë projektuar një sërë aktesh rregullatore, me miratimin e të cilave realizohet harmonizimi i kuadrit ligjor vendas me atë europian.

- AAC ka pasur si objektiv, projektimin, përshtatjen dhe standartizimin e rregulloreve të BE në fushën e transportit ajror, rregullore të listuara në draft aneksin e përditësuar të Marrëveshjes së ECAA, që dërgohet çdo vit nga Komisioni Europian në AAC së bashku me vlerësimet e vizitave vlerësuese të rradhës të kryera në vendin tonë.
- Është bërë projektimi, përshtatja dhe standartizimi në funksion të implementimit të Anekseve përkatëse të ICAO-s në legjislacionin vendas, si një bazë e rëndësishme rregulluese për funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil si autoriteti garantues dhe mbikqyrës i standarteve të transportit ajror.
- Janë evidentua se, referuar matricës së akteve të transpozuar në vijim të Marrëveshjes Shumëpalëshe, gjatë analizës së informacionit:

* Numri total i rregulloreve për tu transpozuar është rreth 84 nga të cilat:

- Rregullore të cilat janë adaptuar deri më tani janë 45.
- Pjesa tjetër janë në proces miratimi në MIE

5.3 Kontrolli, Ruajtja e Cilësisë dhe përfaqësimi në marrdhëniet me jashtë

- Funksioni i kontrollit dhe ruajtjes së cilësisë ka konsistuar në ushtrimin e kontrolleve të brendshme të cilësisë, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirsim në AAC, raportimin e mospërpuethshmerive, menaxhimin e masave korrigjuese, zbatimin e Manualit të Cilësisë në përputhje me standartin ISO i cili është dokumenti bazë për ngritjen e sistemit të menaxhimit të cilësisë në autoritet, duke unifikuar të gjitha hapat që do të ndiqen nga drejtoritë përkatëse në hartimin e rregulloreve, manualeve, proceseve, procedurave. Nëpërmjet këtij Manuali bëhet i mundur vendosja e parimeve kryesore të punës, rritja e cilësisë së punës si në planifikim ashtu dhe në raportim, identifikimi i dokumentave dhe qenia gjithmonë koherent me legjislacionin në fuqi dhe me versionin final, standartizimi i dokumentave nëpërmjet procedurës për menaxhimin e dokumentave, duke përfshirë në të të gjitha tiparet e detyrueshme që duhet të ketë një dokument qoftë ai i brendshëm apo i jashtëm. Gjatë vitit 2018 AAC ka kontraktuar konsulentin teknik për ISO 9001:2015 me qëllim, hartimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për të certifikuar Autoritetin me ISO 9001:2015. Përgjatë

vitit 2019 janë miratuar nga Drejtori Ekzekutiv 18 Procedura të brendshme në funksion të sistemit të menaxhimit të cilësisë si dhe janë rishikuar 3 Procedura.

- Për herë të parë në AAC u krijua Regjistri i Riskut në kuadër të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë.
- U krijua databaza e menaxhimit të të gjitha gjetjeve të AAC-së në të cilën janë të regjistruara të gjitha gjetjet, si ato nga auditet ndërkombëtare (ICAO, EASA, ECAC) dhe nga gjetjet e auditimeve të brendshme të Cilësisë.

Kryesisht për vitin 2019 aktiviteti i SKRC ka konsistuar në:

- Zhvillimin e tre Mbledhje të Rishikimit të Menaxhimit të Cilësisë në AAC
- Për herë të parë u zhvillua takimi i Grupit të Safety në lidhje me analizimin e raportimeve të detyrueshme në Aviacionin Civil.
- Regjistrimi i ngjarjeve në programin ECCAIRS;
- Realizimi i planit të auditimit sipas programit;
- Menaxhimin e dokumentave dhe planifikimin e punës në AAC

5.3.1 Statistikat në lidhje me ngjarjet e raportuara për vitin 2019


Monitorimi i sigurisë së aviacionit është pjesë integrale e funksioneve të ushtruara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë. Duke monitoruar nivelet e sigurisë në industrinë e aviacionit, AAC-ja mund të masë nëse rreziqet e sigurisë janë duke u vlerësuar në mënyrë të duhur dhe të identifikojë fushat në të cilat mund të përmirësohet siguria.

Raportimi i ngjarjeve kontribon në masë të madhe në identifikimin reaktiv dhe proaktiv të rreziqeve të sigurisë dhe ndikon në përmirësimin e masave të sigurisë.

Qëllimi i raportimit të ngjarjeve është përmirësimi i sigurisë ajrore duke garantuar që të dhënat përkatëse mbi sigurinë të raportohen, mbledhen, ruhen, mbrohen dhe shpërndahen. Qëllimi i vetëm i raportimit të ngjarjeve është parandalimi i aksidenteve dhe incidenteve dhe jo përcaktimi i fajit apo i përgjegjësisë.

Në këtë aneks janë paraqitur statistikat për ngjarjet e ndodhura gjatë vitit 2019.


Grafik.1 Numri i ngjarjeve të raportuara gjatë viteve 2014-2019



Grafiku 1 tregon numrin e ngjarjeve të raportuara në AAC me bazë vjetore (2014-2019). Gjatë viti 2019, siç tregohet në grafikun 1 janë raportuar gjithësej 438 ngjarje.


Ky numër paraqet një rritje të lehtë në krahasim me numrin e ngjarjeve të raportuara në 2018, 2017, 2016 dhe 2015, ku janë raportuar respektivisht 388, 336, 305 dhe 246. Duke krahasuar numërin e ngjarjeve të raportuara gjatë këtyre pesë viteve, viti 2018 përfaqëson vitin e dytë me numërin më të lartë të ngjarjeve të raportuara gjatë këtyre katër viteve pas vitit 2014, kur janë raportuar 392 raste. Numri total i ngjarjeve të raportuara në AAC, nga viti 2014 deri në vitin 2019 është 2105 ngjarje. Rritja e lehtë e numrit të ngjarjeve të raportuara në vitin 2019 i atribuohet qëndrimit pozitiv dhe gadishmërisë së Service Providers, për të raportuar ngjarje të cilat nuk kanë efekt të dëmshëm në sigurinë operacionale, por të cilat ndihmojnë në vëzhgimin e trendit negative afatgjatë dhe në parandalimin e incidenteve.

Grafik.2: Numri i ngjarjeve të raportuara në Vitin 2019 së bashku me tre vitet e tjera të fundit.



Grafiku 2, tregon numrin e ngjarjeve të raportuara në AAC me bazë mujore gjatë katër viteve të fundit. Në përputhje me trendin e ngjarjeve të raportuara në vitin e mëparshëm, në vitin 2019 ka patur një rritje të ngjarjeve të raportuara gjatë muajit Mars dhe Prill. Kjo rritje është në përputhje me rritjen e aktiviteteve të avionëve si dhe mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së pasqyrimeve (target reflection), "Equipmenet Factors, Communication Service Air/Ground", Birdstrike dhe Sulmit me Laser. Në muajit Maj-Qershor 2019 vërehet një rënie e numrit të ngjarjeve të raportuara në AAC krahasuar me Maj-Qershor të 2018. Ndërsa në total gjatë vitit 2019 AAC ka marr 40 raportime në lidhje me birdstrike dhe 25 raportime në lidhje e sulmi me laser. Ndërsa në tre mujorin e katërt të vitit 2019 vërehet një rënie e numrit të ngjarjeve të raportuara në AAC.

Grafik. 3: Klasifikimi i ngjarjeve të raportura në vitin 2019 sipas kategorive dhe shkallës së rëndësisë në përqindje



- Duke vëzhguar trendin e raporteve të marra 2019 si dhe në grafikun 3 pasqyruar dhe në Tabelën 1, vlenë të theksohet që një pjesë e rëndësishme e ngjarjeve të raportuara, rreth 57.2% janë të lidhura me sistemin dhe procedurat e ATM-së, përfshirë edhe informacionin Aeronautik dhe shërbimet meteorologjike.
- Si ngjarje teknike janë kategorizuar ato ngjarje që mbulojnë dështimet ose defektet teknike, që lidhen kryesisht me komunikimin, navigacionin, survejimin, pajisjet meteorologjike etj. Ndërsa si ngjarje operacionale janë kategorizuar ato ngjarje që lidhen me shkeljen dhe/ose me mospërputhjen e procedurave të përcaktuara.

Tabela.1: Ngjarjet e raportuara në vitin 2019 sipas kategorive dhe klasifikimit të risku.

	Occurrence without safety effect	Not Determined	Observation	Significant Incident	Incident	Total
ADRM	1	-	-	-	1	2
AMAN	-	-	-	-	3	3
ARC	1	-	-	-	1	2
ATM/CNS:ATM	157	-	52	-	54	263
BIRD	2	-	34	-	6	42
EXTL	-	-	-	-	2	2
F-NI	-	-	-	-	2	2
FUEL	-	-	-	-	1	1
LOC-G	-	-	-	-	3	3
LOC-I	1	-	-	-	2	3
MAC	1	-	-	1	9	11
MED	5	-	-	-	-	5
NAV	-	-	-	-	3	3
RAMP	1	-	1	-	5	7
RI	-	-	-	-	1	1
SCF-NP	-	-	-	-	15	15
SCF-PP	-	-	-	-	3	3
SEC	1	-	24	-	2	27
TURB	2	-	-	-	-	2
UIMC	-	-	3	-	-	3
UNK	-	1	3	-	1	5
WILD	-	-	-	-	1	1
WSTRW	2	-	-	-	4	6
OTHER	5	-	4	-	41	50
Total	179	1	121	1	160	462

5.3.2 Statistika në lidhje me raportimin në USOAP


- Programi USOAP është zhvilluar nga ICAO për të mundësuar raportimin e vazhdueshëm të shteteve në ICAO. Përmes programit/sistemit - shtetet raportojnë përmes NCMC-s.

Shteti ka për detyrim të plotësoj dhe të mbaj të përditësuar kategoritë: SAAQ, Vet-Vlerësimi, EFOD, CAP.

- Për kategoritë
- Legjislacioni
- Organizata
- Licensim Personeli
- Operimi Avioni
- Vlefshmëria Ajrore
- Investigim Aksident dhe Incident
- Shërbimet e Navigimit Ajror
- Aerodromet dhe Shërbimet në Tokë

- Të gjitha kategoritë përfshijnë kategoritë e mëposhtme dhe kërkojnë informacion lidhur me të gjitha gjetjet dhe masat korrigjuese.
- Është mundësuar nga Koordinatori Kombëtar për Monitorimin e Vazhdueshëm një panoramë e statusit të gjetjeve dhe progresit të bërë nga shqipëria nëpërmjet raportimit të vazhdueshëm në programin USOAP.
- Është bërë e mundur Përgjatë 2019 në bazë të komunikimeve të vazhdueshme planifikimi dhe organizimi i 3 workshopeve me ICAO përpara auditimit të Shtator 2020.

Figura. 1: Situata si paraqitet në sistem Implementimi 55.09%



↓ Veprimtaria:

- Gjatë vitit 2019 grupi i punës i cili përmes Planit të Veprimit ka ndërmarrë iniciativën për të përditësuar të gjithë informacionin në sistem në vazhdimsi.

Vlen të themi që informacioni i Shqipërisë së fundmi është riparë:

CMA Audit (Full)	10.12.2009
ICAO Coordinated Validation Mission (LEG, ORG, ANS, AGA)	14.11.2012
Off-Site Validation Activity (PEL, OPS, AIR)	04.04.2014
Off-Site Validation (ORG, ANS)	28.03.2014

Është transpozuar pjesa më e madhe e Aneksëve të ICAO-s, ndërkohë që janë plotësuar në sistemin USOAP, pranë kategorisë EFOD, tabelat e diferencave për anekset e transpozuar.

Janë bërë përditësimet gjatë 2019 dhe është punuar për Masat Korrigjuese:

Kategoria	Statusi
ANS	Përfunduar
LEG	Përfunduar
ORG	Përfunduar
PEL	Përfunduar
AGA	Përfunduar
AIR	Në proces
OPS	Në proces
AIG	Në proces

5.4 Mbikqyrja e Shërbimit të Lundrimit Ajror

Misioni i Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Navigimit Ajror është rritja e standardeve në kryerjen e disa funksioneve kryesore për fushën operationale siç janë:

- Proçesi i Rregullbërjes në fushën e Shërbimeve të Navigimit Ajror
- Proçesi i Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Ofruesve të Shërbimeve të Navigimit Ajror
- Liçensimi i Personelit të Ofruesve të Shërbimeve të Navigimit Ajror

Në mënyrë të përmblodhur kemi këto aktivitete të përfunduara: Janar-Dhjetor 2019

- Është bërë mbikqyrja e Vazhdueshme e ANS/Komunikimet/Aprovimet etj
- Është arritur rritja e kapaciteteve dhe kualifikimeve brenda DHMSHLA (disa trenerime në fushën e ATS dhe Safety) si dhe trajnimet për Cilësinë.
- Është prodhuar LSSP për 2018
- Është përfunduar dhe u firmos Marrëveshja ndërmjet AAC dhe ALBCONTROL në lidhje me të dhënat aeronautike për t'u publikuar në AIP, edicioni 2.0.
- Është bërë aktivizimi i Komitetit për Menaxhimin e Fleksibël të Hapësirës Ajrore
- Është realizuar krijimi i AMC (Airspace Management Cell) midis MIl dhe ANSP si dhe miratimi i AMS Handbook.
- Pritja e EASA-s dhe mitigimin i gjetjeve (gjetjet e vizites së 2017 janë mbyllur)
- Është bërë marrëveshja për bashkëpunimin cross-border midis AAC-ve të Shqipërisë dhe RMV.
- Është zhvilluar Auditi ndjekës në ANSP për gjithë fushat e ATS, MET, AIS, CNS dhe TO
- Është zhvilluar mbledhja e Runway Safety Team midis AAC, Albcontrol, TIA dhe MIL.
- Është zhvilluar takimi në Eurocontrol për Komisionin e përkohshëm
- Draftimi i Reg 923 për SERA (rregullorja është dërguar në MIE),
- Është bërë draftimi i reg 2015/310 që amendon reg 29/2009 mbi kërkesat për shërbimet Data Link në qiellin e vetëm europian (rregullorja është dërguar në MIE),
- Është bërë draftimi Reg 2018/1048 of 18 July 2018 laying down airspace usage requirements and operating procedures concerning performance-based navigation (rregullorja është dërguar në MIE),
- Është realizua nga AAC ka Certifikuar edhe një AME të ri sipas Reg 340/2015
- U lëshua NOTAM mbi Safety Directive të EASA për Boeing 737-8 max, Boeing 737-9 max.
- Është bërë miratim i publikimit të AIRAC AMDT 003/2019 të AIP Albania.
- Është zhvilluar takimi i punës TIA-AAC-ALBCONTROL në lidhje me TWY e TIAs
- Është bërë miratimi i diferencave të ICAOs për publikim në AIP Albania për pjesën GEN 1.7.

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

- Ka kryer Konsultim me Albcontrol Sh.a në lidhje me draftimin e skemës së performancës e cila do të jetë në përputhje me UM Nr. 91, datë 21.02.2019
- U kryen dy trejtime nga ECTL për stafin e ANS, dhe Albcontrol në lidhje me Reg e re EU 373, dhe reg 317 për skemën e performancës si dhe u siguroa mbështetja e ECTL për vitin 2020.
- U zhvillua Auditi në ANSP për gjithë fushat SAF-IOP-SWAL, brenda fushës CNS.
- U zhvillua Auditi në ANSP për gjithë fushat e ATS, MET, AIS dhe TO
- Tre rregullore të reja janë miratuar në harkun në vitin 2019, dy prej të cilave janë të dedikuara për Shërbimet e Lundrimit Ajror dhe një rregullore e cila ka të bëjë me raportimin e detyrueshëm të ngjarjeve në Aviacionin Civil, të cilat kanë rritur aftësitë rregulluese të disa fushave përkatëse si vijon:

Rregulloret ndërkombëtare të miratuara 2019	Data /Titulli i aktit Ligjor
Reg 376/2014/ On occurrence reporting	Urdheri i Ministrit nr. 173, date 12.04.2019 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR RAPORTIMIN DHE NDJEKJEN E NGJARJEVE NË AVIACIONIN CIVIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, qe perafron Reg.376/2014,
Reg 340/2015 on ATCO licensing	Urdheri i Ministrit nr. 91 dt 21/02/2019 “per percaktimin e rregullave dhe procedurave administrative per licensimng e ATCO dhe TO/AME
Reg 923/2012 -SERA	Urdheri i Ministrit nr. 327 dt 28/8/2019 “MBI PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PËRBASHKËTA TË AJRIT DHE DISPOZITAT OPERACIONALE NË LIDHJE ME SHËRBIMET DHE PROCEDURAT E LUNDRIMIT AJROR”

- Janë rivaliduar me rregulloren e re të MIE nr 91 dhe aktualisht ka 72 Kontrollorë të Trafikut Ajror.(Sipas kategorive) gjithë ATCO të ANSP:

ADI/TWR	ACS/RAD	APS/RAD	OJTI	ASS
20	53	31	9	11


- U rivaliduan Gjatë vitit 2019 licensat e 72 Kontrollorëve të Trafikut Ajror në kategoritë ACS, APS, TWR.
 - Kategoria ACS 53
 - Kategoria APS 31
 - Kategoria TWR 20
- Gjithashtu 10 studentë KTA të cilët janë duke zhvilluar trajnimin fillestar për kategorinë TWR dhe AREA të cilët janë në proces licensimi si student kontrollorë.

- Nga veprimtaria mbikqyrese e ANS per 2019 të përmbledhura në 3(tre) auditime kemi pasyren e mëposhteme:


Gjetjet/Rekomandime Tek ANSP	Statusi	Kërkohet/Rekomandohet
8 gjetje nga Auditet 2019	hapur	Kërkohet përmbushja e CAP
1 gjetje nga Auditet 2019	mbyllur	

- Gjatë periudhës të vitit 2019, fluksi i fluturimeve që ka përdorur hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, i detajuar më poshtë ka patur një rritje në krahasim me një vit më parë. Kjo falë edhe strukture së re të hapësirës ajrore, FRALB (Free Route Airspace) e cila këtë sezon veror është aplikuar gjatë gjithë ditës.

Year	ATM Movements
2009	161402
2010	161402
2011	197265
2012	195094
2013	200578
2014	198410
2015	201990
2016	186806
2017	193872
2018	205661
2019	220262



- Ngjarjet e klasifikuara sipas kategorive të ndodhura përgjatë vitit 2019 janë paraqitur sipas grafikës së mëposhtme:



5.5 Mbikëqyrja e Aeroporteve

- Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aeroporteve është përgjegjëse për kryerjen e certifikimit, regjistrimit, monitorimit dhe mbikëqyrjen e aeroporteve në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon dhe mbikëqyrë mjedisin fizik dhe teknik në afërsi të aeroporteve në përputhje me rregullat në fuqi. Mbikëqyrja e aerodromit për operime të sigurta në kuptimin e gjerë nënkupton detyrat të cila janë kryer për zbatimin e programit të mbikëqyrjes në çdo kohë nga ana e AAC nëpërmjet DA për të verifikuar se kushtet sipas të cilave është dhënë një certifikatë vazhdojnë të plotësohen gjatë periudhës të vlefshmërisë të saj.
 - Një nga bazat e menaxhimit efektiv të aerodromit është krijimi i një sistemi efikas mbikëqyrje.
 - Mbikëqyrja përfshin monitorimin e vazhdueshëm të gjithë aspekteve të operimit dhe menaxhimit të aerodromit si dhe të atyre që kryejnë shërbimet në tokë.
 - Monitorimi siguron një metodë tjetër proaktive për identifikimin e rreziqeve, vlerësimin e efektivitetit të veprimeve të sigurisë, si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së sigurisë.
- ✎ Si rrjedhojë Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aeroporteve janë realizuar si më poshtë:

- Ka ndjekur planin e mbikëqyrjes dhe procesit të rregullbërjes.
- U dha pëlqimi për fillimin e punëve përgatitore të nevojshme për aplikimin e certifikatës së Aeroportit të Kukësit.
- Është hartuar manuali udhëzues për certifikimin e ofruesve të shërbimit të përpunimit në tokë, në zbatim të nenit 13 të Udhëzimit të Ministrit Nr. 843, datë 03/12/2018 për “Hyrjen në tregun e shërbimeve të përpunimit në tokë të avionit në aeroportet e Republikës së Shqipërisë”.
- Është hartuar procedura në përputhje me Udhëzimin e Ministrit Nr. 843, datë 03/12/2018 për “Hyrjen në tregun e shërbimeve të përpunimit në tokë të avionit në aeroportet e Republikës së Shqipërisë”.
- Është kryer Uptdatimi dhe rishikimi i gjithë CAP në programin USOAP, për kategorinë AGA.
- Janë hartuar tabelat e përputhshmërisë për rregulloret e transpozuar, konkretisht Urdhri i Ministrit Nr. 122, datë 12/03/2019 dhe Udhëzimi i Ministrit Nr. 834, dt 03/12/2018.
- Është dhënë pëlqimi paraprak AZHT në përputhje me kërkesat e Standardeve të ICAO-s dhe Rregullores 130/2012 për dhënien e lejes së ndërtimit subjektit TIA SH.P.K “ Faza I Rikonstruksioni i rrugëve lidhëse me pistën, TXW B, W2, W.
- Është dhënë pëlqimi paraprak AZHT në përputhje me standardet e ICAO-s dhe në zbatim të Nenit 44, pika 2 e Ligjit 10040, datë 22.12.2008 i ndryshuar “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” për miratimin e lejes së ndërtimit “Godina e re e Stacionit të PMNZ dhe ambienteve ndihmëse të saj”
- Pjesëmarrje në dhënien e mendimeve për Kontraten e Koncesionit të Aeroportit të Kukësit
- Është realizuar audit mbikëqyrës pranë TIA në lidhje me menaxhimin e sigurisë në operim.
- Është kryer përkthimi dhe u hartua draft-rregullorja mbi Aneksin 14, Volumi 2 (Heliportet) si rregullore kombëtare për miratimin e heliporteve në Republikën e Shqipërisë.
- Është mbajtur pranë ambienteve të AAC një takim me përfaqësues nga drejtoritë teknike të cilëve ju prezantua draft-rregullorja për miratimin e heliporteve, ku u kërkuar mendime dhe komente mbi përmirësimin dhe realizimin e një materiali sa më efikas.

- Është plotësuar Shtojca 8.2/8.3 mbi performancën financiare dhe jo financiare të kontratës së Koncesionit të Aeroportit Nderkombëtar “Nënë Tereza”.
 - Është kryer monitorimi dhe matja e performancës dhe cilësisë së shërbimit tek operatori TIA sipas Shtojcës 36 të Marrëveshjes së Koncesionit, si dhe u hartuan raporte javore mbi gjetjet që rezultuan nga monitorimi dhe shkresa mbi sugjerime përkatëse për operatorin aeroportual.
 - Janë hartuar listat e kontrollit në zbatim të Urdhrit Nr. 309, datë 18/06/2019 “Për ushtrimin e auditimit të përgjithshëm pranë Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” për auditimin gjithëpërfshirës që do të realizohet në TIA në datat 8-12 Korrik 2019 në kuadër të mbikëqyrjes së përputhshmërisë me specifikimet e certifikatës së aerodromit të lëshuar më 29/10/2015.
 - Është realizuar audit gjithëpërfshirës Në zbatim të Urdhrit Nr. 309, datë 18/06/2019 “Për ushtrimin e auditimit të përgjithshëm pranë Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza”, pranë TIA-s në kuadër të mbikëqyrjes së përputhshmërisë me specifikimet e certifikatës së aerodromit të lëshuar më 29/10/2015. Në vijim të auditit, u identifikuan gjetjet sipas fushave të caktuara të auditit si dhe u hartua raporti përfundimtar nga DMA, i cili u dërgua pranë operatorit aeroportual brenda afateve të parashikuara.
 - Ka hartuar raportin e auditimit mbi gjetjet e identifikuar gjatë auditit si dhe ju dërgua operatorit aeroportual me qëllim njohjen mbi gjetjet dhe dërgimin nga ana e tyre të një plani për veprimet korrigjuese.
 - Është realizuar takim informues midis DMA dhe “Avioalb Services sh.p.k.” në lidhje me kërkesën për takim mbi shprehjen e interesit për certifikimin e ofruesve të shërbimit të përpunimit në tokë.
 - Është realizuar procesi i inspektimit dhe evidentimit për verifikimin e problematikës së ndërtimeve në kundërshtim me ligjin, në Zonën e Zhvillimit të Aeroportit “Nënë Tereza” në zbatim të Urdhrit Nr. 402, datë 30/07/2019
 - Është realizuar investigimi mbi incidentin e ndodhur më datë 19/09/2019 ndërmjet avionëve 9H-GTC dhe GF08 gjatë momentit të zhvillimit të isa testeve në motorr që po kryente avioni i kompanisë Blu Panorama me Nr. Regjistri 9H-GTC. Në vijim u përgatit raporti i cili ju dërgua DE me rekomandimet përkatëse. Secila nga drejtoritë e përfshira ndoqi në vijimësi implementimin e rekomandimeve pranë TIA-s dhe Albcontrol.
 - Është realizuar mbikëqyrja e ecurisë së projektit Airfield 2020 ne Aeroportin Nderkombetar “Nene Tereza”
 - Është realizuar amendimi i aneksit të specifikimeve te certifikatës së aerodromit Nr. AP-01-2015.
- ✚ Në bazë të Kodit Ajror të RSH, në bazë të Urdhrit të Ministrit të Transporteve Nr.130, datë 11/09/2012, për “Rregulloren për Çertifikimin, Regjistrimin e Aerodromeve dhe Detyrimet dhe Përgjegjësitë Operative që bien mbi Operatorët e Aerodromeve në fushën e Aviacionit Civil” si dhe Manualit Udhëzues i DA janë realizuar auditet dhe inspektimet si më poshtë:

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

PLANI I MBIQYRJES 2019 (DMA)				
Muaji	Lloji i aktivitetit Auditim/ Inspektim/ Teste/Studim	Përshkrimi i aktivitetit (fusha që do mbulohet)	Subjekti/ Operatori, i Audituar/ Inspektuar	Auditorët /Inspektorët/Vëzhguesit
Janar	Auditim/ Inspektim	- Shërbimet De-Icing Anti-Icing - Operimet me shikueshmëri të ulët - Operimet në dimër dhe në kushte të këqija të motit	TIA	EG, GSH, AG
Shkurt	Auditim/ Inspektim	Sistemi i menaxhimit të operatorit, duke përfshirë sistemin e tij të menaxhimit të sigurisë teknike dhe të cilësisë, si dhe sistemin e sigurisë të të dhënave aeronautike dhe raportimi i detyrueshëm i ngjarjeve	TIA	EG, GSH, PH, EH
Mars		Manualet dhe dokumentat e aerodromeve	TIA	ED, GSH
Prill	Inspektim	- Punimet në aerodrome (WIP) - Kontrolli i automjeteve në zonën e lëvizjes	TIA	EG, GSH, SP, PH
Maj		Punimet në aerodrome (WIP)	TIA	EG, GSH, SP, PH, GB
Qershor		Matja e performancës së operatorit sipas shtojcës 36	TIA	EG,GB,MK
Korrik	Auditim gjithpërfshirës	Te gjitha fushat me qëllim verifikimin e kushteve të mbajtjes së certifikatës.	TIA	EG, SP, MK, GB
Gusht	Inspektim	Matja e performancës	TIA	EG, GB, MK
Shtator	Auditim/ Inspektim	- Punimet në aerodrome (WIP) - Standardet e hapësirave dhe përmbushja e performancës	TIA	EG, SP,MK,GB
Tetor	Auditim/ Inspektim	Standardet e hapësirave dhe përmbushja e performancës	TIA	EG, GB,MK
Nëntor	Inspektim	- Punimet në aerodrome (WIP) - Standardet e hapësirave dhe përmbushja e performancës	TIA	EG, GB, SP, MK.


Gjetje të rezultuara gjatë vitit 2019 pranë operatorit TIA janë 37, nga të cilat 27 janë të nivelit 2 dhe dhe observacione janë 10.

5.6 Mbikqyrja e Sigurisë në Aviacion

- Objektivi parësor i DMSA është mbikqyrja për zbatimin me efektivitet të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të pranuar, në fushën e sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë, me qëllim mbrojtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme që rrezikojnë sigurinë e aviacionit civil.
- DMSA nuk është e përfshirë drejtëpërdrejtë në zbatimin e masave të sigurisë, por ushtron përgjegjësitë ligjore në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kërkesave rregullatore dhe në monitorimet për verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat kombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare. Në misionin për garantimin e sigurisë së aviacionit civil ne nuk jemi vetëm.
- ✚ Në funksion të detyrave të DMSA janë realizuar detyrat e mëposhtme:
 - Ka përfunduar transpozimin e Rregullores 1254/2009 të Komisionit Evropian dhe është dërguar për miratim në MIE në datën 31.01.2019, bashkë me materialet shoqëruese (relacion, memo informuese, shkresa përcjellëse).
 - Është hartuar informacioni mbi progresin e DMSA duke i'u referuar aneksit të përditësuar të ECAA-së, dhe përditësim i planit të punës me amendimet e reja.
 - Është kryer përkthimi i ECAC Dok 30 Part II, që referohet si model në procesin e rishikimit të PKSAC i programuar për rishikim për vitin 2019.
 - Rishikimi dhe në vijim miratimi nga Drejtori Ekzekutiv, i Manualit Udhëzues Për Sigurinë e Zinxhirit të Furnizimeve, në vijim të sugjerimeve të SKRC.
 - Përfundim i Programit të Faciliteteve dhe dorëzuar pranë Drejtorit Ekzekutiv.
 - Është bërë vlerësimi dhe në vijim miratimi i Revizioneve të Manualit të Sigurisë së operatorit ajror "Albawings".
 - Është bërë vlerësimi dhe në vijim miratimi i Revizionit Nr.4 të Programit të Sigurisë së operatorit aeroportual TIA.
 - Marrja pjesë në takimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe në vijim plotësuar dhe dërguar pyetësoni i BE-së për kërcënimet hibride në fushën e aviacionit civil.
 - Është hartuar raporti drejtuar Këshillit Drejtues mbi gjendjen e sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", në vijim të ngjarjes së datës 9 Prill 2019.
 - Është kryer komunikimi me TIA dhe Komisionin e Policisë Kufitare, Rinas mbi marrjen e masave urgjente për rritjen e nivelit të sigurisë në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza".
 - Është kryer procesi e transpozimit të Rregullores së Komisionit Evropian Nr.1998/2015 për përcaktimin e masave të hollësishme për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit, në versionin e konsoliduar me të gjithë amendimet deri në janar

- 2019, dhe dërguar për miratim në MIE bashkë me materialet shoqëruese (relacion, memo informuese, shkresa përcjellëse).
- Është përfunduar rishikimi i Programit Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë së Aviacionit Civil, dhe dërguar në MIE për miratim, bashkë me materialet shoqëruese (relacion, memo informuese, shkresa përcjellëse).
 - Ka kryer Hetimi i Sigurisë, në vijim të ngjarjes së datës 09 Prill 2019, hartim i raportit final për MIE, dhe për operatorin aeroportual, dhe ndjekje e procesit të planit të masave korrigjuese.
 - Ka raportuar në ICAO në lidhje me incidentin e sigurisë të datës 09 Prill 2019 sipas format zyrtar të standartizuar.
 - Është kryer përgatitja, organizimi dhe ndjekje e Mbledhjes së Komitetit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, si dhe zbardhje e minutave të takimit.
 - Ka kryer pjesëmarrje në kursin "ICAO Airport Security Supervisors", i cili u zhvillua në ambientet e AAC-së gjatë datave 16-25 Korrik 2019.
 - Ka kryer rishikimi i PKIE 2020 - 2022 - Kapitulli 14 "Politika e Transportit", dhe kapitulli 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria", si pjesë e grupit të punës.
 - Ka Organizuar dhe ndjekur mbledhjen e Komitetit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil (KKSAC).
 - Është përfunduar drafti final i rishikimit të Programit Kombëtar të Sigurisë në Aviacion, dhe materialet shoqëruese (relacion, memo, shkresat përcjellëse), dhe në vijim u dërgua për në MIE për përcjellje për VKM.
 - Është përfunduar drafti final i rishikimit të Programit Kombëtar të Trajnimit të Sigurisë në Aviacion, dhe materialet shoqëruese (relacion, memo, shkresat përcjellëse), dhe në vijim u dërgua për në MIE dhe MB për miratim si Urdhër i Përbashkët.
 - Çertifikimin e personelit të ICTS, në total 16 punonjës (7 shërbim patrulle - agjent dhe 9 operator skaneri – agjent).
 - Çertifikimi i 57 punonjësve të sigurisë të Albcontrol, riçertifikimi i 11 punonjësve.
 - Riçertifikimi i punonjësve të ICTS, në Total 3 punonjës operator skaneri - agjent.
 - Riçertifikimi i punonjësve të Sigurisë të TIA-s në total 83 punonjës, çertifikimi i punonjësve të TIA-s në total 8 punonjës.
 - Është kryer kontrolli i pastërtisë së figurës për personelin e AAC, ICTS, Albawings, Albcontrol, TIA, ICSI. Në total u kërkuar kontrolli i pastërtisë për 757 punonjës.

DMSA ka kryer funksionet e saj monitoruese të paraqitura dhe në grafikun e mëposhtëm.



Gjatë viti 2019 nga inspektimet e rezultuara pranë operatorëve, në vijim të përmbushjes së planit vjetor kanë rezultuar 40 Gjetje, nga këto 24 janë mbyllur , 16 janë të hapura dhe në process për mbyllje nga operatorët.

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Për vitin 2019 aktiviteti i drejtorisë ka konsistuar në realizimin e plotë të planit të mbikqyrjes.

Nr	Data	Lloji i aktivitetit Auditim/Inspektim/ Testim/Hetim	Përshkrimi i Aktivitetit (fusha që do të mbulohet)	Subjekti/operatori i audituar /inspektuar
1	22 Janar	Inspektim	Pajisjet e Sigurisë	TIA
2	19 Shkurt	Test i hapur	Pika e kontrollit të bagazheve të hambarit HBS	TIA
3	13 Mars	Vizitë Vlerësuese	Hapja e pikës së përkohëshme të kontrollit "Porta 3 Jug"	TIA
4	15 Mars	Hetim	Mbi incidentin e sigurisë në fluturimin BPA 222P	TIA
5	19 Mars	Inspektim	Personeli i sigurisë, rekrutimi, trajnimi, certifikimi	ICTS
6	09 Prill	Inspektim	Akses Kontrolli	TIA
7	24 Prill	Inspektim	Zbatueshmëri e masave të sigurisë	Albcontrol
8	12-14 Prill	Hetim	Mbi cënimin e sigurisë gjatë ngjarjes së datës 9 Prill	TIA
9	14 Maj	Inspektim	Kargo dhe posta ajrore	TIA - RA
10	07 Qershor	Test i fshehtë	Pika e kontrollit të pasagjerëve PAX	TIA
11	20 Qershor	Inspektim	Zbatueshmëri e masave të sigurisë	albawings
12	27 Qershor	Test i hapur	Pika e kontrollit të punonjësve Creë & Staff	TIA
13	5-6 Gusht	Inspektim	Operatorët e huaj ajrorë	TIA
14	8 Gusht	Inspektim	Furnizues i Rregullt i Furnizimeve në Fluturim	ICSI
15	27 Gusht	Hetim	Ankesë e pasagjerit për artikujt e ndaluar	TIA
16	16 Shtator	Test i fshehtë	Pika e kontrollit kargo=> Porta A	TIA
17	30 Shtator - 1 Tetor	Inspektim	Operimin dhe kontrollet e sigurisë	TIA
18	10 Tetor	Inspektim	Kargo dhe posta ajrore	TIA - RA
19	17 Tetor	Inspektim	Zbatueshmëri e masave të sigurisë	Albcontrol
20	28-29 Tetor	Vizitë Vlerësuese	Zbatueshmëri e masave të sigurisë	Air Albania
21	14 Nëntor	Inspektim	Furnizimet në fluturim dhe furnizimet e aeroportit	TIA
22	05 Dhjetor	Test i fshehtë	Pika e kontrollit të personelit dhe perimetri	TIA

- 5.7 Mbrojtja e të drejtave të pasagjerëve

- Gjatë vitit 2019 AAC dhe sektori i të drejtave të pasagjerevë në vecanti kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve. AAC ka luajtur rolin e një avokati ndihmës për çdo qytetar, me qëllim mbrojtjen dhe respektimin parimeve bazë të vendosura në rregulloren Europiane EC 261/2004 ,ose UM nr.1 datë 26.02.2013 “Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimit ose vonesës së gjatë të fluturimeve”.

Janë vendosur në aeroport fletëpalosjet me informacion për të drejtat e pasagjerëve:

- (1) udhëzues mbi të drejtat e pasagjerëve kur fluturojnë nëpërmjet ajrit;
- (2) udhëzues mbi të drejtat e pasagjerëve me aftësi të kufizuar lëvizëse;
- (3) udhëzues mbi të drejtat e pasagjerëve për humbjen e bagazheve ;

- SDP ka bërë të mundur mbajtjen nën kontroll dhe monitorimin me presencë nga afër për rastet e vonesave apo anulimeve të fluturimeve, duke kontrolluar apo mbajtur nën vëzhgim shpërndarjen e informacionit nga shoqëria ajrore respektive të info-s mbi të drejtat e pax si dhe në se ka dhënë asistencën e specifikuar të nevojshme sipas rastit.,sipas EC 261/2004 ,ose UM nr.1 datë 26.02.2013.
- Asistuar në rastet kur formularët e mbushur të ankimit janë dorëzuar pranë zyrës së SDP në aeroport apo nëpërmjet rrugës elektronike, është dhënë në vijim asistencë për çdo rast duke vijuar me ndërmjetësim/komunikim pranë shoqërisë ajrore, nëpërmjet komunikimit elektronik nga adresa e pax@acaa.gov.al .
- SDP ka monitoruar procesin drejt dëmshpërblimit sipas përcaktimit kohor për t’u respektuar si dhe ka ushtruar influencën e vet në mënyrë që asnjë rast ankimi i paraqitur të mos lihet mbas dore apo pa u trajtuar nga shoqëritë.
- Ka monitoruar për çdo rast të paraqitjes së ankimeve për dëmshpërblim, është hapur një dosje e vëçantë në emër të pasagjerit ankimes duke përditësuar ecurinë e rastit dhe duke informuar të interesuarin (pasagjerin).
- Ka kryer komunikim dhe konsulencë në vazhdimësi me pasagjerët, nëpërmjet adresës pax@acaa.gov.al në ndjekje të procedurave të ankimit. Ndjekje e rasteve deri në mbyllje të plotë të procedurës në komunikim shkresor dhe elektronik me kompanitë ajrore;
- Ka ndjekur në vazhdim të performancës së operatorëve ajrorë në tregun shqiptar;
- Në vijim të problematikave gjate muajve ne vitin 2019 dhe nga konstatimet e bëra si edhe nga njoftimet apo ankimet e marra prej pasagjerëve ankimes për rastet e vonesave dhe anulimeve **në aeroportet e Italisë**, në mënyrë të vecantë rezultoi se “Ernest S.p.A “ , nuk vepron në përputhje me detyrimet dhe kërkesat e Rregullores Europiane EC 261/2004 , pasi në këto aeroporte nuk ka mkiqyrje dhe Për këtë arsye u ngrit nje komision disiplinor nga AAC ndaj kompanisë ERNEST dhe u mbajt një mbledhje konstruktive midis përfaqësuesve të

kompanisë Ernest dhe AAC , e cila rezultoi në dhënien e një informacioni të detajuar nga kjo kompani mbi numrin e kompensimeve të kryera ndaj pasagjerëve të ankimuar në ngjarjet e ndodhura në fluturimet e vitit 2018 -2019. Edhe Kompania Albaëings ka dërguar email njohës tek SDP mbi numrin e kompensimeve ndaj pasagjereve në rastet e ngjarjeve(vonesa ose anulime) të ndodhura .

- Ka asistuar duke dërguar herë pas here emaile kujtese Kompanive Ajrore për të konsideruar e trajtuar ankesat e pasagjerëve dhe ka theksuar detyrimet e Kompanive për të marre masat e nevojshme mbi respektimin e te drejtave të udhetarëve .
- Mbi çështjen e kompensimeve , për ngjarjet e ndodhura gjatë muajve Tetor-Dhjetor 2018 dhe Jan –Mars 2019 , kemi informacione të herëpashershme të përdituara nga Shoqëria Blue Panorama e cila ka krijuar një tabelë ekseli me numër dokumenti (file number) mbi trajtimin e ankesave të ardhura nga pasagjerët direkt me status çështje të hapura (open case) dmth që janë duke u shqyrtuar deri në reagimin e pasagjerit , dhe disa prej tyre kanë çështje të mbyllura(close file) , kur pasagjeri aprovon formën e kompensimit nga Kompania që mund të jetë në trajtë voucheri , kthim bilete ose në formë cash .

Kompensimet

- Nga emaili i fundit dërguar nga BPA dt 08.03.2019 , në total kemi nga kjo kompani **494 kompensime –CLOSED CASE (Janar 2018-Dhjetor 2018)** dhe rreth **721 raste të hapura (Open Case)**
- Gjithashtu kemi një informacion të dërguar nga Kompania Ernest Spa në datën 25.03.2019 ku për ngjarjet e ndodhura gjatë vitit 2017 dhe 2018 (Jan -Dhje 2018) totali i pasagjerëve të kompensuar është rritur në **615 –CLOSED CASE**
- Pasagjerët e fluturimit të Kompanisë EIZZ AIR kanë hyrë në komunikim direkt me të , pas marrjes së emailit dërguar nga SDP , dhe Kompania ka filluar procesin e trajtimit të ankesave të tyre ku deri në fund të Marsit 2019 kemi **21 raste të hapura OPEN CASE dhe 62 raste CLOSED CASE** me kompaninë WIZZ AIR
- Informacion nga ALBAWINGS për kompensimet te disa pasagjerëve dhe disa çështje të hapura ku rezulton në total **31 pasagjerë të kompensuar** dhe **20 raste të hapura** .
- BRITISH AIRWAYS lajmëroi me email numrin e kompensimeve ndaj pasagjerëve të fluturimit të vonuar nga TIA-LGW/Round Trip në datën 04/03/2019

- Mbi cështjen e kompensimeve , Bazuar në informacionet e dërguara nga Shoqëritë ajrore si me poshte (pervec te dhenave qe kemi nga 6mujori i meparshem) :
- Kompania TUI –Jetair FLY , në një email të dërguar në datën 11.01.2019 , përmend faktin se njohin detyrimin prej 400 eur për kompensim ndaj pasagjerëve të afektuar nga vonesa e datës 26.06.2019 , si pasojë e një defekti teknik të avionit .
- Është njoftuar me emaili të ardhur nga Zyra e të Drejtave të pasagjerëve të Kompanisë Ajrore Albawings në datën 25.10.2019 mbi fillimin e kompensimeve ne fluturimin e vonuar të datës 30.06.2019 TIA-FLR
- Është njoftuar nga JET AIR mbi kompensimet e pasagjereve te fluturimit te vonuar nga TIA –BRU/26.06.2019 , dhe Wizz Air (ku njohin detyrimin per kompensim te pasagjereve me vleren 400 eur), tabela e kompensimeve ka shifrat e mëposhtme :

Në muajin Shtator është për tu përmendur anulimet e shpeshta të fluturimeve të kompanisë slovene Adria Airways nga Tirana në Frankfurt/Munich dhe Ljubjanë/v.v për shkak të vështirësive financiare të Kompanisë deri në **shpalljen e falimentit në datën 30.09.2019** .

Periudha JANAR –DHJETOR 2019

1.ALBAWINGS	14 Formularë / 24 Pasagjerë
2.BLUE PANORAMA	342 Formularë/492 Pasagjerë
3.FLY ERNEST	797 Formularë/1234 Pasagjerë
4.ADRIA AIRWAYS	64 Formularë/74 Pasagjerë
5.WIZZ AIR	91 Formularë/99 Pasagjerë
6.BRITISH AIRWAYS	72 Formulare/ 93 Pasagjerë
7.TRANSVIA FRANCE	65 Formularë /113 Pasagjerë
8.TUI BELGIUM	11 Formularë /12 Pasagjerë

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Tabela e mëposhtme paraqet vonesat mbi 2 orë dhe anulimet e fluturimeve me nisje nga TIA , për të gjithë kompanitë ajrore të programuara që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”.

	KOMPA NIA		JAN AR	SHK URT	MA RS	PRI LL	MA J	QERS HOR	KOR RIK	GUS HT	SHTA TOR	TET OR	NEN TOR	DHJE TOR
1	ALBAWI NGS	Vone sa mbi 2 ore	1		1			3			2	1		
		Anull ime												1
2	AIR ALBANI A	Vone sa mbi 2 ore											1	2
		Anull ime										1- strik e	2- strike	
3	BLUE PANOR AMA	Vone sa mbi 2 ore	4	1	1	1		11	2	3		1- strik e	4	1
		Anull ime						2						
4	ERNES T	Vone sa mbi 2 ore	6	7		6	1	5	5	21	10	16	4	15
		Anull ime	1			1	7- Stri ke					2	1- strike	
5	ALITALI A	Vone sa mbi 2 ore												
		Anull ime	1				1- Stri ke		1- Strike		1	1- strik e	1- strike	1
6	ADRIA	Vone sa mbi 2 ore	1				2	1		2				
		Anull ime	1	1			4				21			
7	AIR SERBIA	Vone sa mbi 2 ore			1			2			1		2	
		Anull ime												
8	AUSTRI AN	Vone sa mbi 2 ore				2		1			2			
		Anull ime	1		1									
9	LUFTH ANSA	Vone sa mbi 2 ore					1		1	1	2			
		Anull ime				1			2		2		3	
10	TURKIS H	Vone sa mbi 2 ore		1			1							

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

		Anull ime												
1 1	WIZZ AIR	Vone sa mbi 2 ore		1			3		2	3	4	1		
		Anull ime												
1 2	JETAIR FLY	Vone sa mbi 2 ore			1		1			2				
		Anull ime		1										
1 3	AEGEAN AIR	Vone sa mbi 2 ore								1				
		Anull ime												
1 4	PEGASU S	Vone sa mbi 2 ore												
		Anull ime		1										
1 5	BRITISH AIRWAYS	Vone sa mbi 2 ore			2		2	2	1	1				1
		Anull ime								3				
1 6	TRANSA VIA (ORY)	Vone sa mbi 2 ore				1	1	2		2				
		Anull ime						1						
1 6	TRANSA VIA (AMS)	Vone sa mbi 2 ore							1					
		Anull ime												

Në lidhje me Burimet Njerzore.

- Realizimi i planit të trajnimeve për vitin 2019 në masën 50%.
- Plotësimi i 8 pozicioneve vakante.
- Punësimi i 4 studentëve të ekselencës në pozicioneve vakante

5.8. Çështje të Administratës dhe Përfaqësimit Ligjorë (Shërbimet e Përgjithshme).

Sektori i Prokurimeve

- Gjatë vitit 2019, puna e sektorit është fokusuar në zhvillimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit më prioritare për mbulimin e nevojave të vitit për shërbimet, punët dhe mallrat. Gjatë këtij viti janë zhvilluar procedurat për lidhjen e kontratave publike më të nevojshme, duke filluar që nga blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, blerje materiale pastrimi, pajisje kompjuterike, shërbim katering, shërbime të lidhura me mirëmbajtjen e automjeteve ekzistuese, blerje automjeteve, siguracion i jetës dhe shëndetit, siguracioni i godinës së AAC, etj.
- Janë zhvilluar në total 77 procedura prokurimi, nga të cilat 3 procedura “kërkesë për propozim”, 17 procedura “blerje e vogël”, 49 procedura “sistem dinamik i blerjeve” dhe 8 procedura me vlerë “nën 100 mijë lekë”.
- Është kryer përditësimi i vazhdueshmë i regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2019 brenda afatit ligjor mbi bazën e programit ekonomik të miratuar dhe rialokimeve, që kanë të bëjnë me ndryshimet e herëpashërëshme të kushtëzuara nga nevojat e lindura rishtaz. Këto veprime administrative janë kryer në zbatim të Udhëzimit Nr. 1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”.
- Është siguruar lehtësimi i kryerjes së shërbimeve që janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së AAC-së, që konsiston në menaxhimin e aktiviteteve rutinë që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit. Është mbikëqyrur kontrata e furnizimit me karburant, është kryer shpërndarja e tij, koordinimi i lëvizjeve të automjeteve, mirëmbajtja e tyre, etj.
- Është mbikëqyrur kontrata e ruajtjes dhe sigurisë fizike të institucionit me ofruesin “Illyrian Guard” Sh.a. Është koordinuar me këtë shoqëri për situata të paparashikuara dhe jashtë vullnetit të palëve, sic është ajo e tërmetit.
- Janë organizuar ceremonitë e pritje – përcjelljeve të delegacioneve të huaja në AAC, për të cilat SKSH ka kontribuar me mbarëvajtjen normale të këtyre ngjarjeve duke nisur që nga përshtatja e ambientit për zhvillimin e eventit, furnizimi me shërbim katering, plotësimi i nevojave me mjete akustike apo pajisje elektronike, si edhe asistencë e vazhdueshme e specialistit të IT-së, etj.
- Në bashkëpunim me specialistët e arkiv-protokollit janë drejt përfundimit dorëzimi i të gjitha dosjeve me materiale shkresore që i përkasin vitit 2018 dhe ato të 6-mujorit të parë 2019.
- Gjatë vitit 2019 problematikë ka shkaktuar anulimi i vendimit për t’u zhvendosur me zyra drejt Tirana Business Park, gjë që solli ndryshime në planifikimin e shpenzimeve dhe

riorganizimin e nevojave institucionale për t'iu përshtatur rrethanave të reja.

- Problematikë ka qënë edhe ngjarja natyrore e tërmetit të 21 Shtatorit 2019, si pasojë e të cilit godina e AAC pësoi dëme kryesisht në plasaritje të mureve të katit të dytë. Këto dëme u vlerësuan dhe u riparuan nga kompania e sigurimeve me të cilën është lidhur kontrata për Sigurimin e Ndërtesës dhe Pajisjeve të AAC-së. Fatmirësisht, në tërmetin e 26 Nëntorit 2019, godina e AAC-së nuk pësoi dëmtime.

Përfaqësimi ligjor


Gjatë vitit 2019 puna e Sektorit Ligjor është fokusuar kryesisht në:

- Ka bërë argumentim ligjor të shkresave/vendimeve/urdhreve të ndryshëm, sipas praktikave në shqyrtim të AAC-së.
- Ka hartuar kontratat për nëpunësit e rinj të emëruar, si ekselentët dhe praktikantët, duke dhënë asistencë juridike sa herë që është kërkuar nga burimet njerëzore.
- Bashkëpunim me drejtoritë e tjera të AAC-së, që kërkojnë interpretime dhe asistencë juridike.
- Është dhënë mendim juridik si dhe janë kthyer përgjigje çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me veprimtarinë AAC-së.
- Janë ndjekur të gjitha çështje gjyqësore në proces, të cilat kanë patur seanca gjatë vitit 2019. Është bërë përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm ligjor për përfaqësim, në shkallë të parë dhe ankimi në apel, raportimi dhe informimi me shkrim për çdo çështje të përfaqësuar.
- Janë ndjekur të gjitha takimet dhe zhvillimet që lidhen me çështjen e Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) në kuadër të Ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar.

5.9 Ceshtjet Ekonomike

Të Ardhurat

Sipas neni 17 të Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ardhurat e Autoritetit realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtaritë që kryen Autoriteti.



Referuar të dhënave të mësipërme, realizimi i cdo burimi të ardhure rezulton si në vijim:

Tarifa e koston en-route, është bërë kalkulimi koston bazë (unit rate) për Shqipërinë sipas metodologjisë së EUROCONTROL-it. Kjo e ardhur merret nëpërmjet ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror Albcontrol, duke qenë se tarifa en-route arkëtohet në total bashkë me koston e Albcontrol-it.

Parashikimi i koston bëhet për një periudhë pesë vjeçare më poshtë po japim koston bazë në vite me një parashikim deri në vitin 2024, në mijë lekë.

Vitet	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Kosto baze	162,000	162,000	167,000	167,000	168,000	169,000	170,000	169,000	168,000

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Realizimi për këtë lloj të ardhure është i plotë në masën 100%. Tarifa e rrugës përbën një nga treguesit kryesorë të të ardhurave të Autoritetit. E ardhura nga tarifa e rrugës për vitin 2019, rezulton me një vlerë 167 milion lekë.

Tarifa e Sigurisë. Të ardhurat nga ky aktivitet për vitin 2019 janë realizuar në masën 98%. Këto të ardhura janë 10 % më shumë krahasuar me realizimin për vitin 2018, dhe kjo për shkak të fluksit të rritur të pasagjerëve në dalje nga Aeroporti “Nënë Tereza”.

E ardhura nga Liçensa e Aeroportit, është përcaktuar në Ligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së konçensionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Konçensionare Tirana Airport Partners sh.p.k, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj Shoqërie”. Kjo e ardhur është në vlerën 50,000 Euro në vit dhe paguhet në një pagesë të vetme nga Aeroporti. Diferenca me parashikimin reflekton kursin e këmbimit të monedhës Euro.

Të ardhura të tjera nga liçencat, certifikime, etj., përfshihen të ardhurat që AAC realizon nga dhënia e liçensave, autorizimeve dhe certifikimeve në fushën e aviacionit civil, në bazë të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrit të Financave, Nr. 2225 datë 13.05.2013, si dhe të ardhura të tjera nga grande, komisione, etj. Gjatë vitit kjo e ardhur është realizuar në masën 151% krahasuar me parashikimin për vitin 2019. Ky nivel i lartë i realizimit lidhet me të ardhurat e arkëtuar për licencën e operimit ajror për 5 vite të Air Albania si dhe certifikata e vlefshëmërisë Ajrore për të.

B. Shpenzimet

Autoriteti i Aviacionit Civil, në bazë të pikës 4 të nenit 17 të Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i përdor të ardhurat paga, shpërblime, mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale të nevojshme për funksionimin normal të institucionit, si dhe për pagesat e kontributeve, që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare të aviacionit civil.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet një krahasim i shpenzimeve të realizuara për vitin 2019 kundrejt programit të miratuar:

000/lekë			
Emërtimi	Programi Vjetor 2019	Realizimi 2019	% e Realizimit
Shpenzime personeli	201,664	146,319	73%
Trajnime Stafi dhe Takime	66,500	31,319	47%
Shpenzime operative	104,420	70,538	68%
Shpenzimet total	372,584	248,176	67%

Totali i shpenzimeve gjatë vitit 2019 rezulton në shumën 248,176 mijë Lekë kundrejt 372,584 mijë Lekë të parashikuara në planin e miratuar të buxhetit.

Zëri “Shpenzime Personeli”, është realizuar në masën 73%, krahasuar me parashikimin. Kryesisht arsyeja e mosrealizimit qëndron në faktin se gjatë vitit 2019 AAC nuk ka operuar me strukturë të

plotë, pasi ka patur vende vakante. Në këtë nivel realizimi ndikon më edhe nënëzëri “Shpërblim i personelit”, si rezultat i dhënies së vetëm të një shpërblimi gjatë vitit 2019, nga dy të parashikuar.

Zëri “Trajnime Stafi dhe Takime” i programuar në shumën 66,500 mijë lekë, është realizuar në vlerën 31,319 mijë lekë ose 47%, kjo për faktin që një pjesë e trajnimeve të miratuara nuk u realizuan brenda vitit 2019. Koha e zhvillimit të një pjesë të trajnimeve përkonte me periudhën kur stafi AAC ka qenë i angazhuar në detyrat funksionale dhe prioritete të institucionit. Ato janë riprogramuar për vitin 2020.

Zëri “Shpenzime Operative” është realizuar në masën 68% krahasuar me parashikimin. Duke qenë se ky zë i programit ekonomik përfshin të gjitha kostot që lidhen me funksionimin e administratës dhe veprimtarisë së AAC-së, ato janë shpenzime të cilat lindin herë pas here dhe realizohen në bazë të nevojës që institucioni ka për to. Nivelin më të lartë të realizimit e kanë shpenzimet siguracionin e godinës dhe ruajtja e sigurisë fizike, pagesës së kuotizacioneve për aderimin në Organizata Ndërkombëtare, shpenzime postare dhe telekomunikacioni, shërbimi i printimit dhe fotokopjimit, etj. Nivel më i ulët i realizimit vihet re në shërbimet e mirëmbajtjes, pasi këto shpenzohen në varësi të nevojës.

Zëri “Shpenzime financiare” ka një realizim në masën 3,920 mijë lekë nga 650 mijë lekë të parashikuara. Ky realizim është si rezultat i vlerësimit të llogarive në monedhë të huaj, me kursin e fundit 31.12.2019, marrë nga Banka e Shqipërisë.

Zëri “Provizione”, për vitin 2019 është parashikuar në vlerën 5,000 mijë lekë duke konsideruar vendimet e pritshme nga Akt-Paditë e ngritura nga ish punonjësit e AAC-së të cilët janë larguar nga puna dhe është realizuar në vlerën 4,598 mijë lekë.

Zëri “Amortizim”, është një shpenzim, i cili përlllogaritet me mbylljen e vitit financiar dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore dhe sipas përlllogaritjeve është në shifrën 11,186 mijë lekë, nga 4,500 mijë lekë të planifikuara. Normat vjetore të amortizimit të marra parasysh në këtë llogaritje janë bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.8, datë 09.03.2018.

C. Investimet

Bazuar në programin e investimeve për vitin 2019, AAC planifikoi investime të financuara nga “burimet e veta”, me vlerë totale 210,974 mijë lekë të ndara këto sipas strukturës së mëposhtme.

Emërtimi	Programi Vjetor 2019	Realizimi 2019	% e Realizimit
Pajisje zyre, informatike & elektronike	44,949	20,251	45.1%
Aktive të patrupëzuara	166,025	45,565	27.4%
Investime total	210,974	65,816	31.2%

Niveli i ulët i realizimit të investimeve vjen kryesisht si rezultat i:

Projekti “Sistemi elektronik mbikqyrjes në Aviacion”, kontrata është lidhur në Tetor 2019 me kohëzgjatje 5 muaj dhe përfundon në Mars 2020. Pagesa e tij është planifikuar në programin ekonomik të vitit 2020.

Çertifikimi ISO 9001:2015, është ri-programuar për vitin 2020. Në Qershor 2019 pas përfundimit të asistencës për hartimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, u miratua kjo procedurë dhe u la kohë që institucioni të vinte në zbatim këtë sistem para se të certifikohet;

Projekti i Droneve nuk është realizuar për faktin se nuk është miratuar ende rregullorja e funksionimit të droneve nga ministria;

Konsulencë për Masterplanin e Aviacionit Civil Shqiptar dhe Kapaciteti i TIA’s nuk janë zhvilluar për mungesë të ekspertëve që do të hartojnë ToRs. Jemi drejtuar MIE dhe TAIEEX me qëllim vënie në dispozicion të një eksperti të fushës. MIE sugjeron ndjekjen e hapësirave ligjore për kontraktim eksperti, ndërsa TAIEEX nuk parashikonte në programin e vitit 2019 ofrimin e kësaj ekspertize. Ky investim është ri-planifikuar për vitin 2020 dhe ekspertët do të kontraktohen nëpërmjet procedurës së prokurimit;

Projekti i godinës dhe ndërtimi janë shtyrë në kohë derisa të kemi një mundësi për të siguruar tokë për ndërtim nga Bashkia e Tiranës.

10 Shtator – 10 Dhjetor 2019, KLSH zhvilloi auditimin e përpueshmërisë në AAC për periudhën Janar 2018 – Gusht 2019. Gjatë kësaj periudhe stafi i DHSHP ka qenë i angazhuar me vënie në dispozicion të dokumentave dhe realizimin e kërkesave për informacion të audituesve të KLSH. Ky fakt ka ndikuar edhe në realizimin e procedurave të prokurimit, një pjesë e të cilave 9 (jo të domosdoshme) u ri-planifikua për vitin 2020.

1. STATISTIKAT

Zhvillimi i Transportit Ajror, dhënia e lejeve të fluturimit

- Sipas të dhënave zyrtare që Sektori i Lejeve të Fluturimit disponon, në vitin 2019 u arrit një shifër rekord për sa i përket numrit të pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet linjave ajrore për/nga vendi ynë. **3,338,149** pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë vitit 2019 për/ nga TIA.
- Gjithashtu nga raportimi vjetor ardhur nga Albcontrol janë shënuar 21,885 ulje – ngritje avionësh dhe 150,675 mbikalime.
- Ulje - ngritjet janë të ndara në: 18,236 fluturime të rregullta, 3,458 fluturime charter dhe 191 avion ushtarak ose të përjashtuar.
- Sektori i Shërbimeve të Lejeve të Fluturimit, ka dhënë 1225 leje për fluturime jo të rregullta që prej 1 janarit 2019 deri më 31dhjetor 2019.


Në Tabelen 1, pasqyrohet numri i pasagjerëve sipas kompanive për vitin 2019.

NR	Shoqëritë ajrore	PASAGJERË	
		Janar - Dhjetor 2019	Zotërimi i tregut në%
1	Swift Air	-	-
2	Adria Airways	95,084	3%
3	Alitalia	235,576	7%


AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

4	Austrian Airlines	184,722	6%
5	British Airways	105,840	3%
6	Jetairfly	60,454	2%
7	Lufthansa	104,451	3%
8	Aegean Airlines	125,925	4%
9	Turkish Airlines	84,402	3%
10	Air Albania	125,072	4%
11	Pegasus Airlines	103,388	3%
12	Blue Panorama	598,495	18%
13	Air Serbia	48,786	1%
14	Albawings	324,489	10%
15	Volotea	-	0%
16	Ernest Airlines	535,037	16%
17	Transavia	38,211	1%
18	Wizz Air	219,066	7%
19	Mistral Air	-	0%
20	Edelweiss	15,419	0%
21	Easy Jet	8,003	0%
22	Transavia (TO)	33,126	1%
23	Pegasus Airlines (Ayt)	17,202	1%
24	Charter	275,401	8%
	TOTAL	3,338,149	100%

Grafiku Nr. 1 pasqyron më qartë zotërimin në total të tregut sipas kompanive përgjatë vitit 2019.



Grafiku Nr. 2: Zotërimi i tregut nga ana kompanive, sipas përqindjes:



- Grafiku tregon se kompanitë që fluturojnë drejt Italisë, si Air Albania Albawings, Blue Panorama, Ernest S.p.A, Alitalia, zotërojnë përqindjen më të madhe në tregun e transportit ajror gjatë vitit 2019, duke zënë përafërsisht 54% të totalit.
- Nëse do të bënim krahasimin e tre viteve të fundit, trafiku ajror dhe fluksi i pasagjerëve këtë vit, ka një rritje prej **13%** krahasuar me vitin e kaluar.


Tabela e mëposhtme jep një informacion të plotë krahasimor për numrin e pasagjerëve sipas shoqërive ajrore, në tre vitet e fundit.

PASAGJERË JANAR- DHJETOR 2017-2018-2019						
	Shoqëritë Ajrore	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019	% e ndryshimit 2018-2017	% e ndryshimit 2019-2018
1	Swift Air	-	-	-		
2	Adria Airways	114,647	116,447	95,084	1.57%	-18.35%
3	Alitalia	282,275	255,781	235,576	-9.39%	-7.90%
4	Austrian Airlines	174,363	168,029	184,722	-3.63%	9.93%
5	British Airways	84,650	97,758	105,840	15.48%	8.27%
6	Jetairfly	45,811	51,247	60,454	11.87%	17.97%
7	Lufthansa	61,236	62,420	104,451	1.93%	67.34%
8	Aegean Airlines	84,860	99,983	125,925	17.82%	25.95%
9	Turkish Airlines	172,719	189,702	84,402	9.83%	-55.51%
10	Air Albania	-	-	125,072		
11	Pegasus Airlines	89,265	99,588	103,388	11.56%	3.82%
12	Blue Panorama	737,168	630,551	598,495	-14.46%	-5.08%
13	Air Serbia	47,126	46,361	48,786	-1.62%	5.23%
14	Albawings	208,261	320,642	324,489	53.96%	1.20%
15	Volotea	11,176	14,516	-	29.89%	-100.00%
16	Ernest Airlines	184,067	363,969	535,037	97.74%	47.00%
17	Transavia	50,652	46,404	38,211	-8.39%	-17.66%
18	Wizz Air	30,321	98,082	219,066	223.48%	123.35%
19	Mistral Air	80,195	11,678	-	-85.44%	-100.00%
20	Edelweiss	-	-	15,419		
21	Easy Jet	-	-	8,003		
22	Transavia (TO)	-	3,205	33,126		
23	Pegasus Airlines (Ayt)	-	4,134	17,202		933.57%
	Shuma	2,458,792	2,680,497	3,062,748	9.02%	14.26%
24	CHARTER	162,227	266,258	275,401	64.13%	3.43%
	TOTAL	2,621,019	2,946,755	3,338,149	12.43%	13.28%

- Përsa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve 2017 - 2018 - 2019, kompania e cila ka përqindjen më të lartë të rritjes për vitin 2019 krahasimisht me 2018 është kompania Wizz Air, 124% më i lartë së në vitin 2018 ka qënë numri i pasagjerëve për këtë kompani.
- Kompania Wizz Air hyri në tregun shqipëtar në vitin 2017 me vetëm një destinacion, Budapestin, duke shtuar destinacionet për ç'do sezon. Në mbyllje të vitit 2019, kompania fluturonte në 5 destinacione dhe deklaroi se në sezonin veror të 2020 do të fluturoj edhe në 5 destinacione të reja drejt Italisë.
- Më pas vjen kompania Lufthansa e cila ka rritje 67% krahasimisht me vitin 2018, kjo rritje bie shumë në sy pasi kompania vitin e kaluar ka pasur një rritje shumë të vogël krahasimisht me vitin 2017.
- Disa nga kompanitë sikurse duket në tabelë kanë ngritje më të vogla, e disa prej kompanive kane ulje të numrit të pasagjerëve krahasimisht me vitin e kaluar, si Blue Panorama e cila ka pësuar rënie në numrin e pasagjerëve nga viti në vit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve për vitin 2019 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018 dhe 2017:

Grafiku Nr. 4: Numri i pasagjerëve për 2017, 2018, 2019 sipas operatorëve ajrorë.



Gjithashtu vlen të theksohet se numri i destinacioneve për fluturimet e nisura dhe mbërritjet në TIA është në rritje të vazhdueshme dhe të konsiderueshme. Këto të dhëna poaraqiten më qartë në grafikun e mëposhtëm





Tabela : Transporti Cargo

Muaji	Viti 2018			Viti 2019		
	Mallra	Post	Total	Mallra	Post	Total
Janar	133.575	48.937	182.512	151.455	46.106	197.561
shkurt	128.233	39.894	168.127	128.803	38.492	167.295
Mars	136.539	38.033	174.572	160.031	40.280	200.311
Prill	154.585	36.689	191.274	142.234	43.846	186.080
Maj	145.805	36.999	182.804	166.760	39.426	206.186
Qershor	145.523	35.770	181.293	150.224	37.559	187.783
Korrik	147.966	32.721	180.687	168.052	35.260	203.312
Gusht	133.395	31.675	165.070	140.495	35.014	175.509
Shtator	147.996	31.675	179.671	148.377	36.165	184.542
Tetor	161.108	44.160	205.268	169.245	44.173	213.418
Nentor	164.325	44.178	208.503	163.081	39.751	202.832
Dhjetor	151.456	46.106	197.562	211.652	36.761	248.413
Totali	1.750.506	466.837	2.217.343	1.900.409	472.833	2.373.242

Grafiku 5: Transporti Cargo sipas operatorëve ajrorë



- Statistikat si më lartë i raportohen çdo muaj Drejtorit Ekzekutiv si dhe Këshilltarit për media i cili më pas i bënë publike në buletinin mujor të AAC.
- Sektori i Lejeve të Fluturimit në vitin 2019 ka dhënë 1225 numra klerance për fluturimet jo të rregullta, ku përfshihen fluturimet charter seri, charter privat, fluturime diplomatike, arial work, cargo etj..
- Për sa më sipër Specialistët e Lejeve të Fluturimit sigurohen që kërkesat e ardhura nga operatorët të marin përgjigje në kohë reale gjithashtu në mënyrë profesionale dhe shumë të shpejtë arrijnë të menaxhojnë fluksin e kërkesave dhe kryejnë detyrën e tyre përgjatë 24 orëve të ditës, ku nuk bëjnë përjashtim ditët e pushimit si dhe ato të festave.
- Specialistët gjithashtu janë në komunikim të vazhdueshëm me Albcontrol për çdo problematikë, si me anë të postës elektronike ashtu dhe ndëpërmjet telefonit përgjatë 24 orëve të ditës. Ky sektor ka treguar vigjilencë në spikatjen e fluturimeve ferry dhe faturimin i shumave përkatëse për llogari të AAC. Gjithashtu në fund të vitit 2019 ky sektor ka vënë në përdorim edhe sistemin e Lejeve të Fluturimit për të lehtësuar punën e operatorëve që kërkojnë leje fluturimi

✎ Liçencat dhe Çertifikatat e lëshuara

- Është realizuar Çertifikimi i Kompanisë Ajrore "Air Albania"
- Është lëshuar Çertifikata e Vlefshmërisë Ajrore CoA (ABN)

- Janë lëshuar Çertifikata e Rishikimit të Vlefshmërisë Ajrore ARC” (ABN,AWT)
- Është lëshuar “Certifikata e Zhurmave NC” (ABN)
- Janë kryer 5 rinovime të “Liçencat e personelit të mirëmbajtjes së avionëve sipas pjesës 66”
- Janë bërë 14 procese Validimi dhe Rivalidimi për Pilotët, të cilët operojnë me shoqërinë “Air Albania” shpk, Mars-Shtator 2019.
- Janë pranuar 7 Anëtarë të lartë, të kabinës (SCCM), për të ushtruar privilegjet e licensës së tyre në shoqërinë “Air Albania” shpk.
- - Është lëshuar certifikata e Ekzaminuesit Aero-mjekësor AME Nr.002, Dr. Iirjan Bashllari, për Certifikimin mjekësor të Ekuipazhit Ajror.
- Është bërë pranimi i certifikatës së ekzaminuesit Aero-mjekësor Dr. Vincenza Indelicato.
- Janë rivaliduar licensat e 72 Kontrollorëve të Trafikut Ajror në katëgoritë ACS, APS, TWR.
- Është bërë certifikimi personelit të ICTS, në total 16 punonjës (7 shërbim patrulle - agjent dhe operator skaneri – agjent).
- Është bërë certifikimi i 57 punonjësve të sigurisë të Albcontrol, riçertifikimi i 11 punonjësve.
- Është bërë riçertifikimi i punonjësve të ICTS, në Total 3 punonjës operator skaneri - agjent.
- Është bërë riçertifikimi i punonjësve të Sigurisë të TIA-s në total 83 punonjës, certifikimi i punonjësve të TIA-s në total 8 punonjës.

Sbënim

- Për shkak të pandemisë nga COVID-19 nuk ka mbaruar akoma certifikimi financiar(pasqyrat financiare) nga auditueset ligjor.
- Në momentin e dorëzimit nga audituesit ligjor, këto pasqyra do tju dërgohen menjëherë.